

Prof. Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk



TË VËRTETAT ISLAME



Prof. Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk

TË VËRTETAT ISLAME

BFIM

RIJASETI
2010

Titulli origjinal i librit
"حقوق إسلامية في مواجهة حملات التشكيك"
"Hakaik islamiye fi muvaxhehet hamelat et teshkik"



Përktheu nga arabishtja
Afrim Tahiri

Redaktor teknik
Halil Berisha

Botues
Bashkësia Fetare Islame e RM – Rijaseti



Botimi i parë
Shkup, 2010



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ndalohej rreptësisht ribotimi i librit, i plotë apo i pjesshëm i tij
pa lejen e botuesit dhe të përkthyesit.

الإهداء - داء

أقدّم مجهودي هذا لأستاذي وزيد الأوقه . . . ف
بجمهورية مصر العربية مؤلف الكت . لب
الأستاذ الدكتور محمود حمدي زقزوق

لسفيرة جمهورية مصر العربية في صوفية . . ا
الدكتورة هيا المراسه . ي

لرئيس مسلم . ي جمهورية . لة مقدونية . . . ا
رئيس العلماء الشيخ سليمان أفندي رجبى



بسم الله الرحمن الرحيم

المقدمة . . .

يسعدني أن أقدم للقراء ترجمة لكتاب " حقائق إسلامية في مواجهة حملات التشكيك " الدراسة العلمية الإسلامية للأستاذ الدكتور محمود حمدي زقزوق وهومن أشهر فلاسفة المسلمين في وقتنا المعاصر، عالم وباحث إسلامي، وبقدرته العلمية الإسلامية أخذ مكانة قيادية في مسيرة الإسلام في العالم الإسلامي بكتاباته الواسعة والعلمية، وهو من العاملين في حقل المسؤولية للمسلمين، ومن الشخصيات الإسلامية المرموقة والتي لها مكانتها الرئيسية في تقدم وتطور الإسلام، ومؤلفاته الإسلامية لها صداها ومسموعة في العالم الإسلامي في الرد على كل مايقال ويدس ضد الإسلام.

في كتابه " حقائق إسلامية " وهي دراسات وأبحاث علمية ترد على الحملة الضارية التي تشوه حقيقة الدين السماوي الإسلام والتي تتهم الإسلام والمسلمين بهتاناً وزوراً، وتعطي صورة مخالفة لما جاء به القرآن الكريم في ظل الشريعة الإسلامية.

وفي كتابه " حقائق إسلامية " أعطي إجابات علمية إسلامية واضحة مصدرها القرآن الكريم والسنة النبوية الحكيمة في الرد كل ما هو غير واضح ويحاول المغلّين في الإسلام تشويه صورته الجليّة، كان جوابه واضحاً وقاسماً للأباطيل والتي تكال بإسم الإسلام. لقد أعطي الأستاذ محمود زقزوق وأضفي على الإسلام المعاصر بفلسفته وضوحاً علمياً ضد جميع المغرضين الحاقدين على الإسلام في المجتمع الإسلامي العالمي وضد المفاهيم الإسلامية الكريمة، وضد الشريعة الإسلامية الحنيفة وضد ما جاء به الرسل والأنبياء.

ولا شك أنه قي كتابه وتوضيحه لمفاهيم إسلامية أعطي إجابة لها مكائتها العلمية، وهي إن دلت، فما تدل إلا على القدرة العقلية والتمكن الإسلامي والعبقرية الواضحة في فهم الإسلام وفي الرد على كل ما يدور في المجتمعات الإسلامية المعاصرة في تصحيح المفاهيم الإسلامية ووضعها في مكانها الصحيح.

إن الكتاب الذي بين أيدينا هو مقدم للمجتمع الإسلامي العالمي، للذين إختاروا في حياتهم الطريق المستقيم، والحياة الكريمة، ونظام سماوي بإختيارهم الإسلام وإقتزارهم به، كحياة لهم، وهو من الكتب النادرة التي قدمت الاستفادة لجميع المستويات، ليس فقط للمجتمعات الإسلامية ذات الثقافة العالية بل إستطاع أن يدخل لعقول جميع شرائح الكادحين في المجتمعات الإسلامية. ولقد رد رداً حكيماً وعلمياً إسلامياً على جميع الأباطيل والمغرضين الحاقدين ضد الإسلام، وأعطى إجابات واضحة على جميع المحاولات المغرضة التي تحاول الكيل ضد الإسلام والدمس في النيل من المسلمين وبردوده أوقفهم مخزولين في مكائهم ومشلولين من متابعة أعمالهم المشوهة المغرضة. التي هي بعيدة عن الحياة الصحيحة والكريمة للبشرية والإنسانية.

هذا العطاء الإسلامي في الفكر الإسلامي لمسلمي حاضرننا اليوم هو غذاء روحي وكرامة عالية يجب على كل مسلم أن يفتخر بها طالباً من كل مسلم أن ينظر للحقيقة بعينها وأن يبتعدوا عن الأداء المادي والإعلام المروغ ضد الإسلام والحياة الإسلامية. وفي عمله اليومي الدؤوب نستطيع القول بدون أي تحيز، إننا اليوم في مجتمعنا المعاصر قل ما نشاهد العطاء المتواصل الذي قام به البوفيسور زقزوق وواصل حياته اليومية بعبائه وتدرجه المتواصل لأعلى الوظائف الرسمية وفي نفس الوقت إنتاجه الوفير من الكتب والبحوث العلمية وهذا يعطيه صفة الشخصية العلمية الفذة النادرة.

ومنطلقاً من كتاب الله وسنة رسوله الكريم في نشر ترجمة هذا الكتاب باللغة الألبانية بإسم الرئاسة الإسلامية العليا لمسلمي جمهورية مقدونيا، أتطلع في هذه الترجمة بأنها مستنير وتوضح، وتجيب على جميع المفاهيم والأسئلة التي تشوب الإسلام وتعطي الطريق الإسلامي الصحيح لحياة المسلم، هذه المفاهيم وللأسف الشديد ما زالت متمركزة في عقول كثير من المسلمين ذو الفهم السطحي للإسلام.

وبإصدار هذه الترجمة لهذا الكتاب الإسلامي القيم باللغة الألبانية هو سلسلة من مجموعة الكتب الإسلامية المرموقة ذات الطابع العلمي الإسلامي البعيد عن الغلو في الإسلام، والتي تتابع يومياً ما يكتب ضد الإسلام، نشاهدها يومياً في تكرارها وعدائها للإسلام والمسلمين، هذه السلسلة من الكتب تعتمد الوضوح في الأدلة والإجابات العلمية المعاصرة مصدرها كتاب الله وسنة نبيه المصطفى محمد بن عبد الله صلوات الله وسلامه عليه .

نسأل الله جل وعلى أن يحمينا من من ظلمات المفاهيم المغلوطة ضد مبادئ الإسلام، متمنياً أن يكون لهذه الترجمة الدور الفعال في توضيح الإسلام الحقيقي البعيد عن الغلو وتعطي الصورة الحقيقية للمفهوم الإسلامي وواقع وحقيقة الحياة الإسلامية والتصدي لكل ماهي مشوه لصورة الإسلام الحقيقية والدراسات الدينية الإسلامية، هذه تمنياتي وأهدافي كمترجم لهذا الكتاب، أمين.

حاج / أفريم أفندي طاهري

الأمين العام للرئاسة الإسلامية العليا
جمهورية مقدونيا

سكوبيا ، 2010م

PËRKUSHTIM

*Profesorit tim të nderuar,
Ministrit të Vakëfit të Egjiptit
dhe autorit të librit
Prof. Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk;*

*Ambasadores së Egjiptit në Sofje
Dr. Heba Elmarasi;*

*Kryetarit të BFIM-së
Reis ul Ulema
H. Sulejman ef. Rexhepit*

Përkthyesi

PARATHËNIE

*Në emër të Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!*

Prof. Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk njihet si filozof, dijetar islam, studjues, thirrës dhe njëkohësisht funksionar i lartë dhe i rrespektuar. Ai është ndër figurat qendrore të zhvillimit të debatit mbi Islamin. Zëri i tij i fuqishëm reagon kundër çdo akuze drejtuar Islamit.

Me librin e tij *“Të vërtetat islame”*, Prof. Zakzuk, mundohet që të japë përgjigje për çdo keqkuptim apo keqinterpretim të Kur’anit Fisnik dhe me një pasion të rrallë, ruan vlerat e larta hyjnore të tij. Në filozofinë e tij ai shprehet preris kundër tiranisë dhe pro organizimit të shoqërisë mbi bazën e arsyes dhe të ligjit të Allahut xh.sh. dhe të Dërguarit a.s. Është armik i intolerancës, i fanatizmit, i obstruksionit dhe mbrojtës i vlerave të larta islame.

I pajisur me një zgjuarsiri të jashtëzakonshme dhe talent të madh për të shkruar dhe debatuar, Prof. Zakzuk, lëvron me sukses fushën e Islamit dhe jep përgjigje për çdo fenomen që shqetëson

sot shoqërinë; gjithmonë duke u bazuar në librin e Allahut xh.sh dhe traditën e Muhamedit a.s.

Librin të cilin e mbani në duar, i dedikohet të gjithë shoqërisë, atyre të cilët për rrugë të veten jetësore, për sistem jete dhe bonton e kanë zgjedhur fenë e pastër Islame, si dhe atyre që për shkak të dezinformatave dhe shpifjeve të shumta, që iu kanë bërë dhe që edhe sot i bëhen fesë Islame, mbeten të pavendosur dhe bëjnë një jetë pa parime, larg frymës së asaj që vendosi Krijuesi i jetës.

Libri ***“Të vërtetat islame”*** është konceptuar kryekëput në formë të pyetjeve të cilave, me një mençuri të pashoqe dhe me një stil shumë të qartë dhe të përshtatshëm me tematikën, bën ndriçimin e shumë dukurive shoqërore, që e shqetësojnë qenien myslimane sot, si dhe ofron alternativa për tejkalimin e asaj.

Për myslimanin e sotëm, kjo vepër është edhe një klithmë e një thirrësi drejtuar atyre që gjërat mos t'i shikojnë përmes fokusit të huaj, të heqin pluhurin e hedhur para syve të tyre nga dikush tjetër. Të vërtetën ta shohin të vërtetë, të mburren me atë që janë, t'u bëhet me dije se edhe ata kanë personalitetet të cilat duhet t'i marrin për model; figura këto shumë më të dobishme e më të pastra se “idolët” e kohës sonë.

Duke pasur pikënisje Kur'anin dhe hadithet e Muhamedit a.s. me botimin e këtij libri në gjuhën

shqipe nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, shpresojmë se do të hedhim pak dritë në errësirën e mosnjohjes së çështjeve që kanë të bëjnë me përditshmërinë, e që fatkeqësisht edhe sot mbeten tabu tema.

Njëkohësisht me botimin e këtij libri edhe në gjuhën shqipe bëhemi pjesë e zinxhirit të dijetarëve të shquar islam të cilët kanë reaguar kundër çdo akuze që në një formë ose tjetër po përsëriten ndaj Islamit sot.

Viteve të fundit ky libër është botuar disa herë nga Këshilli Suprem për Çështje Islame. Për një dobi më të gjerë, ky libër është përkthyer në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht, siç është dhënë edhe në Ueb faqen e veçantë të Këshillit Suprem për Çështje Islame, ndërsa BFIM-ja merr leje për ta përkthyer nga Ambasada e Republikës Arabe të Egjiptit në Sofje, respektivisht nga ambasadorja Dr. Heba Elmarasi e cila me rastin e një vizite që na bëri më 17.11.2006 mes disa titujve që na i dhuroi ishte edhe ky libër, me çka u mundësua që këtë libër ta ketë në bibliotekën e tij edhe lexuesi shqiptar.

E lusim Allahun xh.sh. që të na shpëtojë nga errësira e mosnjohjes së parimeve të shëndosha Islame.

“Shpresojmë që ky libër të ndihmojë në shfaqjen e imazhit të vërtetë Islam dhe në elimi-

nimin e disa shtrembërimeve, si pasojë e mos perceptimit të saktë të mësimave islame dhe besimit të tij." Kjo dëshirë është e autorit. Qoftë edhe e jona! Amin.

h. Afrim Tahiri

Sekretar i Përgjithshëm i BFIM-së

Shkup, 2010

HYRJE

Rrëfimi mbi konfliktin mes të vërtetës dhe gënjeshtërsisë, të mirës dhe të ligës, është një rrëfim i lashtë, kapitujt e të cilit filluan me njeriun mbi sipërfaqen e tokës dhe do të vazhdojnë derisa në këtë ekzistencë do të ketë qoftë një njeri të vetëm.

Islami qysh nga fillimi i tij, zhvillon luftë të pandërprerë kundër të keqes, që skajshmërisht angazhohet në shuarjen e të vërtetës, me të cilën erdhi.

Islami paraqitet si feja përfundimtare hyjnore dhe është harku i fundit në lidhjet mes qiellit dhe tokës. Prej fillimit të tij e deri më sot, ai është ballafaquar me shumë sulme, përmes akuzave të rrejshme, me qëllim të futjes së dyshimit në besimet dhe mësimet e tij.

Është një aspekt mahnitës se Islami përfaqëson fjalën e fundit të fesë së Allahut. Nuk mohon asnjë nga të dërguarit e mëparshëm e as atë çfarë u është zbritur atyre nga librat qiellore. Ai nuk detyron askënd nga ithtarët e feve të mëparshme qiellore për të pranuar Islamin. Çështja madje nuk ka të bëjë me mosmohimin, por Islami vendosi, që besimi në të dërguarit e Allahut dhe ajo çfarë u është shpallur atyre nga librat, të jetë nga

kushtet fundamentale në besimin e çdo myslimani, kusht pa të cilin besimi nuk është i saktë.

Nga kjo pozitë tolerante e Islamit kundrejt feve të mëparshme është që ai duhej të pranohej me tolerancë të ngjashme dhe të pakësohej numri i armiqve të tij. Mirëpo, ndodhi krejtësisht e kundërta. Gjatë historisë Islami është ballafaquar me fushata të egra nga të gjitha anët sa që nuk mund të ketë në botë ndonjë fe tjetër që është ballafaquar ngjashëm me atë, sepse masmediat ndërkombëtare atakojnë përmes padrejtësive flagrante dhe shpifjeve të rrejshme. Kjo shpjegon se kemi të bëjmë me një injorancë skandaloze ndaj Islamit dhe keqperceptimin e mësimave të tij, qoftë kjo me vetëdije ose pa të, me një përzierje të qartë mes Islamit si fe dhe sjelljeve në emër të fesë nga disa myslimanë marroqë.

Tejkalimi i kësaj bëhet përmes angazhimeve të shumëfishta shkencore për të arritur deri në zbardhjen e imazhit të vërtetë islam dhe përhapjen e tij gjithandej.

Ç'është e vërteta, akuzat të cilat bëhen kundër Islamit, që nga shfaqja e tij e deri më sot, janë akuza të përsëritura. Nuk dallohen mes vete, pos nga stili, ose orvatja për t'u dhënë trajta shkencore. Mendimtarët islam janë ngritur në kohëra të ndryshme për të bërë atë që duhej, për t'u përgjigjur atyre, secili sipas mënyrës dhe metod-

ës së tij të veçantë që besonte se është mënyra më e fortë për t'u përgjigjur.

Neve nuk mohojmë kontributin e atyre që na kanë paraprirë në këtë sferë, e as që pohojmë se sollëm diçka që të tjerët deri më tani nuk sollën, mirëpo neve deshëm, që përmes këtij libri, të japim një reagim kundër çdo akuze që, në një formë ose tjetër, po përsëriten; në veçanti në këtë epokë të informacioneve, kontakteve dhe përdorimit të tepërt të internetit.

Viteve të fundit ky libër është botuar disa herë nga Këshilli Suprem për Çështje Islame. Për një dobi më të gjerë, ky libër është përkthyer në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rusisht, siç është dhënë edhe në Ueb faqen e veçantë të Këshillit Suprem për Çështje Islame.

Shpresojmë që ky libër të ndihmojë në shfaqjen e imazhit të vërtetë islam dhe në eliminimin e disa shtrembërimeve, si pasojë e mos perceptimit të saktë të mësimëve islame dhe besimit të tij.

Prof.Dr.Mahmud Hamdi Zakzuk

Ministër i Vakëfit të Egjiptit

Kryetar i Këshillit Suprem për Çështje Islame

2004

KREU I PARË

KUR'ANI FISNIK

(I) KUR'ANI, SHPALLJE HYJNORE APO E ARRITUR NJERËZORE?

1. Kur'ani Fisnik është libri i parë mbi të cilin bazohet besimi islam dhe dispozitat e sheriatit. Është burim i moralit dhe etikës islame. Është libër i dëshmuar si shpallje hyjnore që, në asnjë farë mënyre, nuk mund t'i vishet e pavërteta. Së këndejmi, besimi në të është i pashmangshëm.

Nisur nga kjo, që nga e kaluara e deri më sot, forcat antiislame bënë gjithçka që ishte në mundësitë e tyre për të lëkundur besimin në autenticitetin dhe origjinalitetin e Kur'anit.

Politeistët e Mekës bënë gjithçka që ishte në mundësitë e tyre për ta sfiduar besimin se Kur'ani është shpallje hyjnore, dhe thoshin se:

“...Ky (Kur'ani) nuk është tjetër, vetëm se gënjeshtër, që e trilloi ai (Muhamedi), të cilit i ndihmuan njerëz të tjerë. Pra ata (idhujtarët) bënë shtrembërim e shpifje.” (el Furkan:4)

“Dhe thanë (për Kur'anin): Janë legjenda të të parëve, që ai (Muhamedi) kërkoi t'i shkruhen

dhe t'i lexohen atij mëngjes e mbrëmje.” (*d Furkan:5*) dhe se Muhamedi a.s.¹ ishte i mësuar nga ana e ndonjë njeriu:

“..Atë (Muhamedin) e mëson një njeri!” (*en Nahël:103*)

Ata madje dëshmonin se Kur'ani i Madhëri-shëm është vepër magjistari ose prifti, me qëllim që të mohohet se është shpallje hyjnore, shpallur Muhamedit a.s. për ta udhëzuar njerëzimin.

Një pjesë e orientalistëve u vërsulën me akuza duke u orvatur të bindin se Kur'ani nuk është shpallje hyjnore por është nga Muhamedi a.s. Në fakt, orientalistët herë pas here sillnin akuzat të cilat më herët u thanë nga politeistët, përkundër faktit se, të njëjtat në mënyrë të prerë, u asgjësuan nga Kur'ani Fisnik.

Dihet mirëfilli se Pejgamberi a.s. nuk njihte shkrim dhe lexim, se për këtë arsye obligoi disa nga sahabët - shokët e tij që të merren me shkrimin e shpalljes që i arrinte. Sikur të mund të lexonte dhe shkruante, ai nuk do të kishte nevojë të kërkonte ndihmë nga dikush t'i shkruante ajetet kur'anore. Pohimet se ai ka krijuar në bazë të librave të shenjta të mëparshme, jo vetëm që janë të



¹ a.s. është shkurtesa e shprehjes *alehiss salam* që d.m.th. paqë qoftë mbi të. (Shënim i përkthyesit)

rrejshme, por janë edhe qesharake. Si mund që diçka e tillë të arrihet nga dikush që nuk din lexim. Si dhe kur është e mundur ajo të ndodh? Po-himet e këtilla thjesht janë thashetheme, të cilat nuk mund të mbështeten në asnjë farë faktesh.

2. Muhamedi a.s. predikoi mesazhin e tij rreth trembëdhjetë vjet në Mekë, kohë gjatë së cilës absolutisht nuk kishte ndonjë lidhje mes tij dhe hebrenjve, ky është një fakt historik i konfirmuar. Kurse lidhur me kontaktet e tija me të krishterët u shtuan tej mase. Nga një takim kur Muhamedi a.s. ka qenë në moshën nëntë ose dymbëdhjetë vjeçare me rastin e udhëtimit me xhaxhain e tij Abdul Mutalibin për në Siri, kur karvani u ndal për një pushim të shkurtër, me ç'rast takoi Bahirin - një murg i krishterë, me të cilin ka biseduar për disa minuta, vetvetiu bën të pyesësh:

Si është e mundur që një djalosht i asaj moshe t'i perceptojë principet, normat dhe fundamentet e religjionit brenda disa minutave, sa Bahiri bisedoi me të?!

Përse Bahiri nga të gjithë njerëzit e karvanit e zgjodhi pikërisht Muhamedin a.s. për t'ia mësuar principet e religjionit të krishterë?

Përse Muhamedi a.s. pas takimit me Bahirin priti tridhjetë vite për ta kumtuar fenë e re?

Andaj, ky lloj rrëfimi në asnjë far mënyre nuk është i besueshëm.

Kështu shprehet edhe njëri nga orientalistët, i cili këtë rrëfim e hedh poshtë, si të shpikur. Orientalisti Huart thotë, se asnjë dokument i studiuar arab dhe dorëshkrim nuk e përkrahin këtë pohim të rrejshëm dhe shtoi; "Roli të cilin gjoja e paska pasur prifti sirian, është aspak më shumë se një tregim i modelit imagjinues."²

3. Kur'ani Fisnik është në ujdi me religjionet e mëparshme hyjnore në besimin e një të vetmit Zot, Krijuesit të universit dhe se të gjitha krijesat duhet t'u drejtohen Atij. Zoti vet është burimi i të gjitha feve, nga këtu, nuk duhet të ketë mospajtime mbi parimet fundamentale. Megjithëkëtë, Kur'ani Famëlartë kundërshton shumë besime të cilat hasen në burimet e besimit hebraik dhe të krishterë. Atëherë si mund të pohohet se Muhamedi thirret në burimet hebraike dhe krishtere? A nuk do të ishte më e kapshme që të mos kishte asnjëfarë dallimi ose, së paku dallimet të ishin sekondare, por ato kanë të bëjnë me parime fundamentale.

4. Kur'ani Fisnik përfshinë fakte shkencore të cilat shkenca i zbuloi në kohën bashkëkohore³ si



² Shih: "El Med-hal ila el Kuran el Kerim", dr. Muhamed Abdullah Draz, *Dar el Kalem*, Kuvejt, 1971, f.134.

³ Shih: Moris Bukaj: "El Kuran el Kerim vet tevrat vel inxhil vel ilm, diraset el kutub el mukadese fi dov il mearif el hadithe", *Dar el Mearif*, 1978.

shembuj nga kjo janë: zhvillimi në etapa i embri-onit dhe deri te formësimi në fetus, dielli, hëna, planetët, era, shiu etj. E nga ku erdhi Muhamedi a.s. me këto? Askush nuk mund të thotë se ai në këto është ndihmuar nga burime krishtere ose hebraike, pasi që ato nuk përfshijnë diçka të këtillë, e sa është e logjikshme që ai vetvetiu erdhi me to, kur ishte i pashkolluar, nuk dinte as shkrim e as lexim?

Padyshim se të gjitha faktet shpijnë në atë se ato ishin nga Zoti dhe se burimi i Kur'anit nuk mund të jetë vepër njerëzore.

(II) A THUA KUR'ANI ËSHTË KRIJUAR NË BAZË TË FEVE TË MËPARSHME

1. Nëse Kur'ani vërtet do të kishë qenë krijuar në bazë të librave të feve të mëparshme, kundërshtarët e të Dërguarit a.s. a do të rrinin të qetë dhe ta injoronin këtë çështje? Pa dyshim se do ta kishin shfrytëzuar rastin për ta akuzuar dhe për ta zbuluar, mirëpo tërë atë që pohuan, nuk ishin pos çështje të pabazuara, me mungesë të dëshmive. Në Kur'anin Fisnik përmenden këto pohime dhe hedhja e tyre, siç u tha më herët.

2. Kur'ani i Madhërishëm përmban shumë li-gje, rregulla, instruksione dhe urdhra që nuk ka-

në ekzistuar në librat e mëparshme. Krahastime, Kur'ani përmban tregime me sqarime detale për gjeneratat e mëparshme, siç përfshinë dhe paralajmërime të cilat vërtet ndodhën ashtu siç paralajmëroi ai. Një shembull për ata ishte rezultati përfundimtar nga konflikti ndërmjet romakëve dhe persianëve. Këto ishin çështje të cilat nuk ishin të njohura nga Pejgamberi a.s. as nga populli i tij e as nga ithtarët e feve të mëparshme.

3. Kur'ani Fisnik thërret në dituri, respektimin e mendjes, shfrytëzimin e saj. Në përputhje me këtë, mbështetur në njohuritë dhe rregullat e reja të Islamit, myslimanët ishin të aftë që për një kohë relativisht të shkurtër të vendosin civilizimin, që do të zëvendësojë civilizimet e mëparshme. Dhe pati sukses të lulëzojë edhe shumë shekuj. E sikur Kur'ani të ishte i nxjerrur nga fetë e mëparshme, përse ato fe nuk përfshijnë urdhërat dhe mësimet e lartpërmendura dhe të kishin rolin e Islamit?

4. Kur'ani Fisnik, i tëri është libër i lidhur, në radhitje, stil, mësim, e sikur të ishte i përbërë nga librat e mëparshëm, do të ishte pa ndonjë lidhje logjike, kontradiktor dhe jokonsekuent, kjo si pasojë e burimeve të ndryshme.

Përveç kësaj, Kur'ani Famëlartë çdoherë ligjëron logjikën, nuk përfshin motive dhe legjenda.

Mbështet faktin dhe qartësinë dhe këtë ua kërkon edhe armiqve të tij:

“...atëherë sillni ju një sure të ngjashme dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë!”
(el Bekare:23)

“...Thuaj: Sillni argumentet tuaja nëse jeni të sinqertë!” (en Neml:64)

Kjo mënyrë është krejtësisht një mënyrë e re, së këndejmi, nuk mund të jetë e huazuar nga fetë e mëparshme.

5. Kurse sa i përket kulturës së xhahilijetit-paganizmit, për të cilën gjithashtu është thënë se Kur'ani është mbështetur në të, e sakta është se Islami plotësisht e hedh besimin pagan, adetet e liga dhe traditat e saja brutale. Islami ato i zëvendësoi me besim të vërtetë, adete të mira dhe tradita të pranueshme. Cila është pra, ajo kulturë pagane të cilën e përvetësoi Islami?

(III) A ËSHTË E VËRTETË SE KUR'ANI FISNIK NUK SOLLI RISI?

Përgënjeshtimeve të përmendura mund t'u përgjigjemi edhe përmes këtyre pikave në vazhdim:

1. Kur'ani Fisnik ka sjellë informacione të cilat për ithtarët e librave të mëparshëm ishin plotësisht të panjohura. Psh. Kur'ani sjell rrëfimin për Zeqerian a.s. lindjen e virgjëreshës Merjem së cilës i është kushtuar një sure e plotë, e që është e pakrahasueshme me Dhiatën e Re. Atëherë nga është e mundur që Pejgamberi a.s. t'i ketë fituar këto informacione?

2. Në "Ekzodus" tregohet se Musai a.s. ende si foshnje ishte birësuar nga ana e vajzës së Faraonit, përderisa sipas Kur'anit Fisnik vërtetohet se grua ja e Faraonit e ka gjetur dhe e ka birësuar. Në "Ekzodus" mund të lexojmë se: *"Haruni e ka përpunuar arin, dhe e modelon në formë të trupit..."* (1/150) dhe se ishte i adhuruar nga ana e hebrenjve, ndërsa Kur'ani vërteton se Samiri ishte fajtori, e jo Haruni a.s. i cili mohonte një gjë të atillë.

3. Nëse Kur'ani i Madhërishëm është i nxjerr nga Inxhili, atëherë përse ai e hedh parimin e Trinitetit, i cili përbën besimin krishterë themelor?

Përse nuk gjejmë besimet në sakrificën e Kryqit, mëkatin e vërtet dhe hyjninë për Isaun a.s.?⁴

4. Kurani Fisnik i paraqet peygamberët e Zotit për ideal ndershmërie dhe morali, kurse Dhiata e Vjetër pohon se disa prej tyre kanë kryer mëkate, e kjo nuk përputhet me pozitën e peygamberëve, sipas këndvështrimit Islam. (Psh. Shih në Dhiatën e Vjetër rrëfimin rreth Lutit a.s. me të bijën e tij).

5. Ibadetet - adhurimet në Islam me të cilat erdhi Kur'ani Fisnik, si; namazi, agjërimi, zeqati dhe haxhi, shpjegimet rreth mënyrës së kryerjes së tyre, janë çështje të cilat nuk janë përmendur në asnjërën nga fetë e mëparshme. Namazi pesë herë në ditë që kryhet në mënyrë të caktuar dhe në kohë të caktuar, agjërimi në muajin Ramazan për çdo vit duke abstenuar nga ushqimi, pija dhe kënaqësive fizike nga mëngjesi deri në mbrëmje. Zeqati, mënyra e dhënies, llojet e tij, haxhi me gjithë atë që përfshin, tavafin qëndrimin në Arafat, ecja mes Safasë dhe Mervës, hedhja e guralecëve në Mina... që të gjitha janë ibadete të cilat nuk përfshihen në asnjë fe në këtë formë si na erdhi Islami. Nëse do të ishin të marra nga ndonjë fe tjetër, atëherë ku dhe cila është ajo fe e cila kishte diçka të këtillë?



⁴ Zakzuk, Mahmud: "**El Islam fi miraati el fikr el garbij**", *Dar el Fikr el Arabij*, 1994, f. 76,77,85.

(IV) A THUA TUBIMI I KUR'ANIT KA SHKAKTUAR NDONJË DYSHIM NË AUTENTICITETIN E TEKSTIT TË TIJ?

1. Ka pasur shkruar të njohur të cilët i zgjidhte Pejgamberi a.s. nga mesi i sahabëve të tij që, menjëherë e shkruanin çdo shpallje kur'anore që atij i arrinte. Shkruanin në çdo gjë që lejonte në të shkruhet, si pergamenti, druri, copa të lëkurës, rrasa ose eshtra. Në përputhje me konstatimet autentike islame, numri i shkruarve arrin në njëzet e nëntë. Më të dëgjuarit ndërmjet tyre, ishin: Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.anhum – pëlqimi i Allahut qoftë mbi ta, pastaj Mua-viu, Zubejri Ibën Avami, Seid Ibën As, Amër Ibën As, Ubej Ibën Ka'b, Zeid Ibën Thabit r.anhum etj.

2. Krahas shkruarve të zgjedhur të cilët i shkruanin ajetet e shpallura kur'anore, ekzistonte edhe mënyra e të ruajturit të shpalljes përmes memorizimit-hifzit, traditë kjo e cila vazhdon deri më sot. Qindra mysliman memoruan Kur'anin Fisnik gjatë jetës së Muhamedit a.s. dhe u specializuan në leximin e ajeteve të tij. Pejgamberi a.s. pat njoftuar se për çdo vit gjatë muajit të Ramazanit në prezencë të Xhebrailit a.s. bënte përsëritjen e Kur'anit Fisnik, kurse në vitin e

fundit, Xhebraili a.s. ia përsëriti atë dy herë, me çka Kur'ani mori formësimin final në mendjet e hafizëve kah fundi i jetës së Pejgamberit a.s., ashtu siç edhe shkruesit e shpalljes vendosnin çdo ajet sipas instruksioneve të të Dërguarit të Allahut xh.sh.

3. Një vit pas vdekjes së Muhamedit a.s. shtatëdhjetë hafizë u vranë në luftën e El Jemamit kundër Musejlem Kedhdhabit - gënjeshtarit, kështu Omer Ibën Hatabi këshilloi kalifin Ebu Bekir që ta angazhojë Zeid Ibën Thabitin, njërin nga shkruesit, me të cilin mund të koleksionon dokumente të ndryshme, që nga koha kur u shkrua Kur'ani dhe t'i ketë të shkruara në kopje të përmbaruara, me çka do të ishte më lehtë që më vonë të jepet çfarë do qoftë vërejtje për to. Duke u nisur sipas kësaj rregulle, e cila ishte e imponuar, dorëshkrimet e shkruara konsideroheshin autentike dhe të pranuar, ose u kundërshtuan si jo mjaftë autentike. Për dorëshkrime autentike u konsideruan vetëm ata që u treguan nga ana e Muhamedit a.s. dhe që u dëshmuan nga ana e dy dëshmitarëve. Natyrisht se në këtë u ndihmuan edhe me hafizët e Kur'anit nga sahabet. Kur Zeid Ibën Thabiti e mbaroi misionin e vet me vërejtje në Kur'anin e shkruar, ai ia prezantoi Ebu Bekrit, i cili para se të vdiste ia dorëzoi Omer Ibën Hata-

bit, i cili para se të vdiste, të njëjtat dorëshkrime ia dorëzoi vajzës së tij Hafsës.

4. Në kohën e Kalifit Othman Ibën Afan, u formua një këshill nga katër shkrues, duke e përfshirë edhe Zeid Ibën Thabitin. Këta shkrues shkruan pesë kopje nga dorëshkrimi origjinal i ruajtur prej Hafsës. Kopjet u dërguan në Mekë, Medinë, Basra, Kufa dhe Damask. Këta katër shkrues të zellshëm dhe preciz e kopjuan dorëshkrimin origjinal dhe duke u kontrolluar gjithashtu nga hafizët e Kur'anit që nga koha e Muhamedit a.s. Kur'ani që tani është në qarkullim në të gjitha vendet e botës islame, të gjitha fraksionet islame, prej atëherë e deri më tani, pasi kaluan katërmbydhjetë shekuj, në mesin e myslimanëve pranohet si i tillë. Kjo çështje u vërtetua nga orientalistë ndërmjet të cilëve edhe Lobloisi, Muiri dhe orientalisti bashkëkohor gjerman Rudi Paret i cili në përkthimin e tij të Kur'anit Fisnik, në parathënie thotë: *"Nuk kemi arsye të dyshojmë se cili do qoftë ajet në Kur'an do të kishte mund të shkruhej nga ndonjë njeri tjetër, përveç se nga Muhamedi."* Me këtë donte të thotë se pas vdekjes së Muhamedit a.s. askush nuk ndryshoi asgjë në Kur'an e ashtoi ndonjë fjalë e as që mënjanoi.⁵



⁵ Shih rreth kësaj: "**El Med-hal ila el Kuran el Kerim**", dr. Muhammed Abdullah Draz, nga f. 34 e më tutje, dhe gjithashtu: Rudi Paret: "**Der Koran**", Übersetzung. Stuttgart 1980, f.5.

Është konfirmuar se nuk ekzistojnë kopje të mus-hafit ndryshe nga ajo e kohës së Kalifatit të Othman Ibën Afanit. Sikur ndonjëri nga sahabet e Pejgamberit a.s. të kishte çfarë do qoftë dorëshkrimi tjetër në pronësi të tij, ata do ta theksonin dhe do të krijonin kopje të autorizuar. Mirëpo një gjë e këtillë nuk u përmend në historinë e Islamit, madje as sekte të cilat myslimanët i konsiderojnë si të shkëputura nga Islami, si psh. Ahmedizmi, hasim se ruajtën tekstin e njëjtë të pranuar nga të gjithë myslimanët, pra, pa shtuar në të e as mënjanuar nga ai.

5. Kurse ajo që është përhapur mbi sahabiun Abdullah Ibën Mesudin se kinse ai ka qenë i mendimit se suret *el Fatiha*, *el Felek* dhe *en Nas* nuk janë pjesë nga Kur'ani Fisnik, absolutisht nuk është konfirmuar se ka thënë diç të atillë. Ekziston konsensus i dijetarëve mysliman se Abdullah Ibën Mesudi është i pastër nga ky pohim i rrejshëm. Nga ata të cilët u kundërpërgjigjen kësaj thashetheme ishin: Imam Fahrudin Raziu, El Kadi Ebi Bekër, Imam Neveviu, Imam Ibën Hazëm, Imam Bakilani etj. Historia nuk thotë se ndonjë mysliman ka mbështetur këtë mendim që si i rrejshëm i vishet Ibën Mesudit.⁶



⁶ Shih: "**El Istishrak vel halfijje el fikrije lis sira el hadari**", Mahmud Zakzuk, *Dar el Meerif*, 1997, nga f. 97 e më tutje.

KREU I DYTË

PEJGAMBERI MUHAMED A.S

(I) A THUA MUHAMEDI A.S ME POROSINË
PËR ISLAMIN U DËRGUA VETËM PËR
ARABËT OSE PËR MBARË NJERËZIMIN?

1. Kur Muhamedi a.s. për herë të parë publikoi thirrjen njerëzve, ai u tha:

“Unë jam zëdhënës i Zotit, veçmas për ju, dhe për mbarë njerëzimin.”

Kjo d.m.th. se që nga momenti i parë, Islami është fe për mbarë njerëzimin. Pejgamberi a.s. asnjëherë nuk e prezantoi fenë vetëm për arabët, por si fe botërore për të gjithë. Kjo vërtetohet edhe në një hadith ku thotë:

“Çdo pejgamber u dërgua deri te populli i tij, ndërsa unë u dërgova për mbarë njerëzimin.”⁷

2. Lexuesve të ajeteve Kur'anore me qartësi mund t'u sqarohet se Kur'ani Fisnik thërret njerëzit - që të gjithë- në fenë e Allahut xh.sh. Kjo cilësi botërore në shumë ajete të zbritura në Mekë para hixhretit – (emigrimit), është e qartë sikur ndriçimi i diellit. Në Kur'an thuhet:



⁷ Transmetoi Buhariu në disa vende, psh. në librin *et Tejemum*.

“Nuk të kemi dërguar ty (Muhamed) veçse mëshirë për botërat.” (*el Enbija:107*)

Ngjashëm me këtë, edhe sureja *el Fatiha* me të cilën fillon Kur'ani, fillon me këto fjalë:

“Hamdi (falënderimi) i takon Allahut, Zotit të botëve.” (*el Fatiha:1*)

Kjo ishte sure e cila zbriti në Mekë para hixhretit të Muhamedit a.s. para se myslimanët të kishin shtetin e tyre islam në Medinë.

3. Nga kjo që u tha deri më tani na qartësohet se nuk kemi të bëjmë me ndryshim të planeve nga ana e Muhamedit a.s. por me ndjekje të procedurës, mënyrës graduale në vendosjen e ligjit. Çështje kjo e logjikshme dhe shumë e natyrshme.

Është e pamundur që aty për aty të flaken shprehjet e formuara të sjelljes, të cilat janë të ngulitura thellë në njerëzit. Kështu Islami në fillim u përqendrua në përforcimin e besimit në shpirtat dhe mendjet e tyre, që kjo të jetë baza mbi të cilën arrihet ndryshimi gradual te njerëzit. Këtë model Islami e ka ndjekur në disa dispozita, sikur ndalimi i alkoolit, kamata, eliminimin e robërisë etj. Periudha Mekase pra ishte për përforcimin e besimit që në periudhën Medinase me lehtësi të arrihet ndërtimi mbi të.

(II) CILAT KANË QENË SHKAQET E MARTESA VETË PEJGAMBERIT A.S.?

1. Muhamedi a.s. ka qenë 25 vjeçar kur u martua me Hatixhen, gruan e tij të parë, e cila ka qenë e moshës afër dyzet vjeçare dhe e martuar dy here më parë. Ajo ishte me të 28 vjet - deri në vdekje. Muhamedi a.s. gjatë kësaj kohe nuk u martua me asnjë grua tjetër dhe gjithnjë mbeti besnik ndaj kujtimeve për të. Ky lojalitet në vitet e më vonshme të jetës së tij kishte shkaktuar xhe-lozi mes disa grave.

2. Natyra e të Dërguarit a.s., karakteri dhe mënyra e jetesës para dhe pas shpalljes, në mënyrë të prerë mohojnë atë se ai ka qenë njeri i dhënë pas epsheve. Si është e mundur që njeriu i cili ka qenë në moshë mbi 50 vjeçare, përnjëherë të ndryshohet dhe të bëhet rob i epsheve të tija, pasi që të gjitha ato mundësi i kishte deri sa ishte i ri, sikur bashkëmoshatarët e tij. Përkundrazi, ai ishte i pastër.

Nga mesi i grave të Muhamedit a.s. e vetmja që më parë nuk ka qenë e martuar ishte Ajsha r.a.⁸ kurse të tjerat, ishin të veja, martesa me të



⁸ r.a. shkurtesa e shprehjes *radijallahu anha* për gjininë femërore si dhe i shprehjes *radijallahu anhu* për gjininë mashkullore, që d.m.th. pëlqimi i Allahut qoftë mbi te. (Shënim i përkthyesit)

cilat ka ndodhur për shkaqe humane, fetare dhe jo edhe për qëllime epshore.⁹

3. Pasi që Muhamedi a.s. mbushi pesëdhjetë vjet, u martua me Sevdën r.a. bijën e Zum'ait e cila ka qenë grua e vejë e njërit prej sahabëve, e që nuk njihej për bukuri, as për pasuri dhe as që ishte nga ndonjë familje e njohur. Ai u martua me qëllim që ta mbrojë atë dhe familjen e sahabiut nga torturat që myslimanët pësonin atëkohë në rrugën e Allahut. Kurse martesë e tij më vonë me Ajshen r.a. (bijën e Ebu Bekrit r.a.) dhe Hafsën r.a. (bijën e Omerit r.a.) ishin me qëllim që të përforcohen lidhjet me Ebu Bekrin dhe Omerin.

4. Kurse sa i përket Umu Selemes r.a. ajo ka qenë grua e vejë e një shهدي të betejës në Uhud. Ajo ka qenë një grua e moshuar, dhe në momentin kur Pejgamberi a.s. i propozoi martesë, ajo për shkak të moshës së saj kërkoi falje dhe deshi ta rrefuzonte ofertën, por Pejgamberi a.s. arriti që ta ngushëllojë dhe e martoi për shkaqe humane.

I Dërguari a.s. e martoi edhe Remlen, të bijën e Ebu Sufjanit r.a. e cila emigroi në Abisini së bashku me bashkëshortin e saj, i cili kishte hequr dorë nga feja islame dhe kishte kaluar në krishterizëm, kishte shkurorëzuar Remlen duke e lënë pa mbi-



⁹ Zakzuk, Mahmud: "Islam fi mira'at el fikr el garbij", f. 31/ 42.

këqyrje. Kështu, Muhamedi a.s. i dërgoi një porosi Nexhashiut, kryetarit të Abisinisë, duke kërkuar që Remle r.a të kthehet në vendlindjen e saj, ta shpëtojë nga kurbeti dhe nga familja e saj në Meke, nga ku ishte e përndjekur. Muhamedi a.s. përmes kësaj martese njëkohësisht shpresonte se do të ndikojë te babai i saj që ta pranojë Islamin, e që atëkohë ishte njeri me autoritet në Mekë.

Pejgamberi a.s. gjithashtu u martua me Xhuv-ejrien r.a. të bijën e Harithit r.a. i cili ishte një nga robërit e luftës të kapur në betejën e Beni Mustalak. Babai i saj ishte udhëheqës i fisit të tij dhe për këtë arsye Muhamedi a.s. u martua me vajzën e tij, me qëllim ta lironte atë prej burgut dhe njëkohësisht u kërkoi myslimanëve që të lirohej tërë fisi i tij prej burgut dhe të lireshin të lirë.

Muhamedi a.s gjithashtu u martua edhe me Safijen (hebraike) e cila ishte e bija e udhëheqësit të fisit hebraik Beni Kurejdha. Safija fitoi lirinë dhe ju dha mundësia të zgjedh mes kthimit te populli i saj, ose martesës me Muhamedin a.s. e ajo zgjodhi qëndrimin me Muhamedin a.s. kundrejt kthimit në familjen e saj.¹⁰

5. Sa i përket martesës me Zejneben r.a. të bijën e Xhahshit r.a. ishte për qëllim legjislativ. Ajo



¹⁰ El Akad, Abas: "Hakik el Islam ve ebatil husumihi", Kajro, 1957, f.192.

ishte e martuar me djalin e adaptuar të Muhamedit a.s. Zejd Ibën Harith. Martesa e tyre nuk zgjati shumë dhe ata pas një kohe u ndanë. Në atë kohë ndër arabët ekzistonte tradita e ndalesës së martesës mes burrave me gratë e shkurorëzuar të djemve të tyre të adaptuar.

I Dërguari a.s. ka qenë i urdhëruar nga Allahu xh.sh. që të martohet me Zejneben r.a. me qëllim të çrrënjësjes së traditës së panevojshme. Në lidhje me këtë flet ajeti në vijim:

“... E pasi Zejdi e kishte vendosur ndarjen e saj, Ne ta kurorëzuar ty atë, e që të mos kenë besimtarët vështirësi në martesë me gratë e të birësuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i Allahut është i kryer.” (el Ah zabë 37)

(III) SA ËSHTË BINDJA NË AUTENTICITETIN E SUNETIT - TRADITËSË MUHAMEDIT A.S.?

Disa nga orientalistët perëndimorë dyshonin në autenticitetin e haditheve, sunetit - traditës së Muhamedit a.s. Goldziheri, psh. konsideron se janë shpikje të myslimanëve të periudhës së parë të Islamit.⁹ Kësaj u kundërpërgjigjemi me sa vijon:



⁹ Zakzuk, Mahmud: “**El Istishrak vel halfije el fikrije lis sirra el hadari**”, *Dar el Maarif*, 1997. f. 106 e më tutje

1. Suneti i pejgamberit është burim i dytë Isl-am pas Kur'anit Fisnik. Muhamedi a.s. ishte i ur-dhëruar përmes Kur'anit për të kumtuar atë çfarë i shpallej nga ana e Zotit, njëkohësisht ishte i obliguar edhe për sqarime të së njëjtës.¹⁰ Ky sqar-im është suneti, i cili përfshin fjalët, veprat dhe pëlqimet e Tij. Pejgamberi a.s. vet vuri në dukje domosdoshmërinë e përkushtimit të traditës së tij gjatë fjalimit të njohur në haxhin lamtumurës:

“U lash juve dy punë, pas të cilave më nuk do të humbni, Librin e Allahut dhe traditën time.”¹¹

2. Nuk mohojmë se ekzistojnë thënie të shpik-ura, të rrejshme, që i janë veshur Muhamedit a.s., por për asnjë moment ato për dijetarët myslima-në nuk ishin të fshehura. Mu për këtë, ata në më-nyrë të kujdesshme kanë kontrolluar çdo hadith.

Kur'ani Famëlartë vendosi që ata para vetes të kenë kriterin më të rëndësishëm të kritereve të kritikës, ai thotë:

“O ju që besuat! nëse ndonjë i pandershëm u bart ndonjë lajm, sigurohuni mirë...” (el Huxhu-ratë6).



¹⁰ ***“O i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën, atëherë nuk e ke kryer detyrën.”*** (el Maide67)
“Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre...” (en Nahël 44)

“Në nuk të shpallëm ty për tjetër Kur'anin, vetëm që t'u sqarosh atyre...” (en Nahël:64)

¹¹ Transmetoi El Hakimi në **“El Mustedrek”**.

Ky kriter shihet edhe në faktin se personaliteti i transmetuesit paraqet faktor të rëndësishëm në gjykimin e transmetimit të tij. Myslimanët e shfrytëzuan këtë kriter në mënyrë madhështore, duke e aplikuar ndaj transmetuesve të haditheve të pejgamberit. Nga aplikimi i kësaj metode të kritikës u zhvilluan gradualisht rregullat e kritikës historike.¹²

3. Marrë parasysh rëndësinë e sunetit në fenë islame, dijetarët myslimanë kanë dhënë mundin maksimal në verifikimin dhe dallimin mes atyre që janë të saktë dhe jo të saktë, kështu ata shpikën shkenca të reja të hadithit në shërbim të këtij qëllimi. Me këtë rast kemi disiplina shkencore që merren me karakteristikat e transmetuesve, zinxhirin e transmetuesve, e tjera. Domethënë, që të gjitha studiojnë gjendjen e transmetuesve, ajo çfarë dihet e çfarë nuk dihet për ta, e gjithë kjo për të vërtetuar se në ç' masë është sinqeriteti i asaj që transmetojnë nga i Dërguari a.s. i cili, duke tërhequr vërejtjen në këtë drejtim, ka thënë:

“Kush qëllimisht gënjen mbi mua, e pret vendi i zjarrit.”¹³



¹² Shih: **‘Texhdid el Fiker ed Dini fil Islam’**, dr.Muhamed Ikbāl, f.160 etutje.

¹³ Transmetoi Buhariu dheMuslimi.

4. Si model nga disa modele të kontributit të dijetarëve islamë në verifikim të hadithit, po përmendim atë të Imam Buhariut (810-870), i cili tërë jetën ia përkushtoi lëmisë së hadithit. Ky dijetar ka mbledhur më shumë se gjysmë milioni hadithe, të cilat, pasi i kontrollloi dhe i studioi me përpikëshmëri, në koleksionin e tij të haditheve, si rezultat i kriterëve të rrepta që kishte vendosur në verifikimin e autenticitetit të tyre, ai nuk miratoi mbi nëntë mijë hadithe. Nëse i eliminojmë hadithet që na transmetojnë domethënie të njëjta, të përsëritura, në Sahihun e tij, na ngelin diku tre mijë hadithe. Kështu bënë edhe dijetarët tjerë të hadithit.

5. Pas angazhimit të madh të dijetarëve myslimanë në drejtim të verifikimit të autenticitetit të haditheve, myslimanët në këtë sferë njohin gjashtë libra, ato janë: Sahihu i Buhariut, Sahihu i Mislimit, Suneni i Nesaiut, Suneni i Ebu Davudit, Suneni i Tirmidhiut dhe Suneni i Ibën Maxhës. Ekzistojnë edhe shumë libra të tjerë islamë të cilat vënë në dukje hadithet e dobëta, jo autentike, të trilluara, të pa miratuara, numri i të cilave arrin me mijëra.

Nga kjo që u tha shihet se studiuesit myslimanë i shërbyen sunetit të Pejgamberit a.s. në mënyrë që, diç të ngjashme nuk mund të gjejmë në asnjë nga popujt e tjerë. Që atëherë e këndej, çdo

tentim për të paraqitur dyshime në lidhje me këtë çështje, është krejtësisht i padrejtë.

(IV) A EKZISTOJNË KUNDËRTHËNIENË HADITHET E PEJGAMBERIT A.S. ?

Njëra nga tentimet e futjes së dyshimit rreth haditheve të pejgamberit është çështja e kundërthënieve mes haditheve. Këtë çështje e prekim me qëllim që burimit të dytë Islam ti humb vlera që në bazë të saj të ndërtohen dispozitat fetare. Në këtë kontekst, dua të shtoj disa argumente kyçe me të cilat do të vijojë paragrafi në vazhdim.

1. Kur'ani i Madhërishëm detyron myslimanët që të veprojnë sipas asaj që thoshte dhe e bënte Pejgamberi a.s. Në lidhje me këtë na flasin ajetet në vazhdim:

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.” (en Nisæ:80)

“...Çka t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çka t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. ” (el Hashër:7)

Hadithet e Pejgamberit a.s. përmbajnë punë që na lejohen, që na kërkohen dhe punë (prej atyre)

që na ka ndaluar. Nga këtu, Suneti pra, është domosdoshmëri nga e cila nuk mund të heqim dorë, në fakt, një gjë e tillë bën të jemi mosrespektues të vet Kur'anit Fisnik.

2. Nuk ekzistojnë vështirësi për të dalluar hadithet autentike nga ato joautentike, ngase dijetarët myslimanë, siç u përmend më herët, kanë kontribuar gjatë shekujve. Pasi që Suneti është burimi i dytë i Islamit, nuk mund që të anashkalohej ky burim për shkak se dikujt i duket se mes disa haditheve paska kundërthënie. Nëse eventualisht hasen kundërthënie – ato nuk janë të vërteta, mund që të sqarohen aspektet e saktësisë, duke përforsuar me transmetime autentike në bazë të normave, kritereve të sakta shkencore, të vendosura nga shkencëtarët e lëmisë së hadithit.

3. Hadithet e Muhamedit a.s. janë interpretimet, shpjegimet e asaj që erdhi në mënyrë të thuktë në Kur'anin Fisnik, e si mund të anashkalohej për shkaqe insinuatash? Ne si myslimanë i kryejmë namazet tona ditore sipas mënyrës që na e sqaron neve Suneti i peygamberit. Detajet në lidhje me namazin me të cilat vjen Suneti, nuk gjenden në Kur'anin Fisnik. Në këtë drejtim kemi shembuj të ngjashme dhe të shumta.

4. Librat e shenjta të feve të mëparshme na arrijnë në mënyrë të ngjashme me mënyrën se si neve na kanë arritur hadithet peygamberike, mirëpo askush nga ithtarët e atyre feve nuk kërkoi që të heqin dorë nga to për shkak se në to ka kundërthënie ose disa lajme të pakonfirmuara. Në një situatë të këtillë, mendja, logjika, domosdoshmërisht thërrasin në verifikimin e transmetimeve, një gjë të këtillë e bënë dijetarët myslimanë në lidhje me hadithet e peygamberit.

KREU I TRETË



PËRHAPJA E ISLAMIT, E VËRTETA MBI XHIHADIN DHE ÇËSHTJA E DHUNËS

(I) A ISHTEI ZGJERUAR ISLAMI PËRMES SHIPATËS?

1. Në Kur'anin Fisnik ekziston një rregull e theksuar esenciale, kushtuar të drejtës në fe:

"Nuk ka shtrëngim në Fe." (el Bekara 256)

Nga këtu, çështja e besimit ose mosbesimit në fenë islame janë nga çështjet të cilat, në esencë lidhen me dëshirën dhe bindjen e brendshme të vet njeriut. Në Kur'an thuhet:

"Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë." (el Kehf: 29)

Në këtë të vërtetë gjejmë se Allahu xh.sh. Pejgamberit a.s. i bëri me dije se e tija është vetëm të kumtuarit e thirrjes – bartja e mesazhit dhe se nuk është nën pushtetin e Tij që njerëzit ta pranojnë atë:

"A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?" (Junus:99)

"E ti pra këshillo se je vetëm përkujtues. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!" (el Gashije 21, 22)

"Nëse ata refuzojnë, Ne nuk të kemi dërguar ty roje të tyre. Detyra jote është vetëm të kumtosh." (esh Shura:48)

Nga kjo bëhet e qartë se Libri i shenjtë i myslimanëve, në mënyrë të prerë e hedh detyrimin ndaj dikujt me qëllim të pranimi të fesë islame.

2. Islami e ka përcaktuar modelin të cilin obligohen ta ndjekin myslimanët në thirrjen e tyre për në Islam dhe zgjerimin e tij. Ky model përfshinë urtësinë, këshillën e mirë dhe polemizimin e mirë:

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe diskuto me ata për atë që është më e mira..." (en Nahël:125)

"...dhe njerëzve thuaju fjalë të mira." (el Bekare 83)

Kur'ani Famëlartë përmban mbi njëqind e njëzet ajete që e nënvizojnë rregullën esenciale që du-

het të ndiqet, bindjen me qetësi, mësimet, lirinë e plotë të njerëzve pas thirrjes për t'iu përgjigjur ose mohuar atë. Me rastin e qirimit të Mekes, Muhamedi a.s. u është drejtuar mekasve me fjalët:

“Shkoni, jeni të lirë”, pra përkundër fitores së tij vendimtare, ai nuk i detyroi që ta pranojnë Islamin.¹⁴

3. Nuk ka ndodhur që myslimanët të kenë ushtruar presion ndaj ndonjë hebraiku ose të krishteri të kalon në Islam, nga këtu, Omer Ibën Hatabi - kalifi i dytë, popullit të Jerusalemit u ofroi sigurinë për jetë, kisha, kryqin, duke mos lejuar që dikush prej tyre të dëmtohet e abuzohet për shkak besimit të tij. Muhamedi a.s. pas hixhretit në Medinë në Kushtetutën e parë shënoi se hebrenjtë janë komb dhe së bashku me myslimanët përbëjnë shoqërinë e re në Medinë duke u njohur atyre të drejtën për të ruajtur fenë e tyre.

4. Orientalistja gjermane Sigrid Hunke në librin e saj *“Allah ist ganz anders”*¹⁵ (Allahu është krejtësisht ndryshe), ka përgënjeshtuar akuzimet se Islami është zgjeruar me ndihmën e shpatës. Ajo thotë: *“Toleranca arabe ka luajtur rol të rëndësi-*



¹⁴ El Gazali, Muhamed: **“Miet sual an el Islam”**, Dar Thabit, 1973, Vëll. I, f. 118, 120.

¹⁵ Ky libër është i përkthyer në gjuhën arabe nën titullin **“Allah lejse kedhalike”**, dhe është botuar nga Dar el Shuruk.

shëm në përhapjen e Islamit, kryekëput e kundërta e pohimit të rrëjshëm se ai është përhapur mendihmën e zjarrit dhe shpatës. Kjo akuzë kundër Islamit është e padrejtë” Ajo gjithashtu shton: “Ithtarët e feve të tjera, d.m.th. krishterët, hebrenjtë politeistët, me vetë-dëshirë kaluan në islam.”¹⁶

Është e njohur se ushtritë myslimane asnjëherë nuk e kanë sulmuar Azinë Jugore ose Afrikën Perëndimore, por atje Islami u zgjerua përmes tregtarëve të devotshëm mysliman, pasi që te ata njerëzit vërenin në praktikë sjellje, moral, trajtim të mirë, çështje të cilat për njerëzit ishin tërheqëse dhe bëri që ata me dëshirë ta pranojnë Islamin.

(II) A ISHIN ÇLIRIMET ISLAME FORMË E KOLONIALIZMIT?

1. Çlirimet islame nuk ishin kolonializëm. Kolonializmi, ashtu siç e njohim në kohën bashkëkohore, merrej me plaçkitjen e pasurisë së vendit nën kolonializëm, shkatërrimit të ekonomisë së saj dhe mosinteresim për zhvillim ekonomik, kulturor, industrial, punë këto të cilat sipas asaj që dëshmon historia, nuk hasen në çlirimet islame.



¹⁶ Hunke, Sgrid: “**Allah ist ganz anders**”, Horizont Verlag, 1990, f..42. Lexo gjithashtu: “**El Islam fi mirat el fikr el garbij**”, nga f.106.

Andaluzia është pjesë e Evropës, pasi ajo ra në duar të myslimanëve, u shndërrua në vend që lulëzoi në të gjitha sferat. Secili historian mund të krahasojë mes saj dhe vendeve të tjera evropiane të asaj kohe, që të vërehet se çfarë progresi solli Islami. Kësisoj ishte gjithkund ku hynin myslimanët. Gjurmët e mbetura të arkitekturës dhe civilizimit islam dëshmojnë për këtë.

2. *Xhizja* ishte tatim që jepej nga banorët e vendeve që binin nën administrim të shtetit islam e, përmes së cilës shteti islam obligohej për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre. Në raste kur ndonjëri përfshihej në ushtrinë islame, lirohej nga *xhizja*.

Sr Tomas Arnold, në lidhje me këtë, sjell shembullin me fisin Xheraxhime, fis i krishterë që banohte në fqinjësi të Antakisë. Ky fis ishte në paqe me myslimanët dhe në marrëveshje për t'u ndihmuar, për të luftuar bashkë në betejat me myslimanët, me kusht që të mos i obligohet *xhizja*¹⁷

3. Xhihadi në rrugën e Allahut, me qëllim që të fitohet materialisht, rrefuzohet nga Islami, madje konsiderohet për krim. I Dërguari i Allahut është pyetur në lidhje me një person, i cili lufton për



¹⁷ Arnold, Thomas W, "**Ed Da've ila el Islam**", përkthimi në gjuhën arabë nga Hassan Ibrahim dhe të tjerë, *Mektebe en Nehda el Mesrije* Kajro, f.79, 80.

interesa të kësaj bote, d.m.th. arritjen e të mirave materiale, e ai është përgjigjur:

“Nuk ka shpërblim për të.”

Duke e përsëritur këtë tre herë.¹⁸

4. Pohimet se zgjerimet islame ishin një formë kolonialiste me apetite ekonomike, bien poshtë kur të merret parasysh se çfarë bëri kolonializmi perëndimor bashkëkohor në vendet islame, krejt ndryshe nga myslimanët në të kaluarën. Dallimi mes tyre është jashtëzakonisht i madh. Po përmendim një shembull në mesin e shumë rasteve të këtilla, që asgjëson pohimin se zgjerimet islame ishin për shkaqe ekonomike. Në një marrëveshje të Halid Ibën Velidit me disa popuj të qyteteve në afërsi të *El Hijer* regjistrohet se ka thënë: *“Nëse ne (myslimanët) u mbrojmë nga armiqtë, neve na takon xhizeja, nëse nuk u mbrojmë, e me pasurinë e juaj e kemi për obligim tu mbrojmë, kurse neve nuk po kemi mundësi, u kthehet pasuria që e morën prej jush. Nëse Zoti na ndihmon kundër atyre dhe na dhuron fitorë, atëherë kushtet e marrëveshjes do të mbeten.”*¹⁹



¹⁸ El Gazali, Muhamed: **“Miet sual an el islam”**, Dar Thabit, 1973, Vëll.II, f. 42.

¹⁹ Arnold, Thomas W, **“Ed D’a’ve ila el Islam”** f.79.

(III) CILI ISHTE QËNDRIMI I MYSLIMANËVE MBI CIVILIZIMET E LASHTA DHE DJEGIESË BIBLIOTEKËS SË ALEKSANDRISË?

1. Nuk është e vërtetë se myslimanët nuk i kanë respektuar civilizimet e lashta. Në fakt, ata përfituan dhe morën çfarë ishte pozitive nga ato civilizime. Përkthyen në gjuhën arabe shumë libra greke, persiane, indiane etj. nga bindja se trashëgimia njerëzore i inkorporon shkathtësitë, përvojat dhe mësimet nga kombet e ndryshme, nga të cilat duhet përfituar. Në lidhje me këtë transmetohet nga i Dërguari a.s. se ka thënë:

“Urtësia është gjë e humbur për besimtarin, kudo që e gjen, ai është më meritori për të.”²⁰

Gjithashtu edhe transmetimi:

“Kërko dituri, madje edhe nëse është në Kinë.”²¹

Kjo domethënë se dituria duhet kërkuar qoftë edhe nga ata që nuk i takojnë fesë tuaj, qoftë ajo edhe në vendet më të largëta të botës. Atëkohë për arabët Kina konsiderohej si vendi më i largët në botë.

2. Filozofi mysliman Ibën Rushdi në lidhje me qëndrimin e Islamit mbi civilizimet antike është




²⁰ Transmetoi Ibën Maxhe në Librin e Zuhd.

²¹ Shih, “Keshful Hifa”, Vëll.I, f.138.

shprehur me fjalët: *"Ligjvënësi obligon studim të librave të mëparshëm, pasi synimi që kanë për qëllim është ai për të cilin Ai obligon: vështrimi logjik në ekzistencë hulumtimi i njohurive"* Pastaj shton, *"Vështrimi në atë që kanë thënë dhe çfarë kanë argumentuar në librat e tyre. Ajo çfarë tek ata është në ujdi me të vërtetën, e pranojmë prej tyre, gëzojemi me të dhe u jemi falënderues, e ajo çfarë nga to nuk është në ujdi me të vërtetën, u bëjmë vërejtje dhe e refuzojmë"* ²²

3. E vërteta shkencore dhe historike dëshmon se myslimanët nuk e kanë djegur Bibliotekën e Aleksandrisë. Ky akuzim i padrejtë dhe i padëshmuar ishte i shpikur nga ana e armiqve të Islamit, të cilët kanë zgjeruar thashetheme, që janë konfirmuar në mendjen e popullit, edhe pse nuk janë dëshmuar fakte. Ky akuzim i rrejshëm është zgjeruar deri në shek. XIII si rezultat i sjelljes agresive të kryqëzatave madje edhe më tej përsëritet deri në ditën e sotme edhe, përkundër dëshmisë autentike nga ana e historianëve objektivë që e kanë mohuar këtë akuzë.

Ky pohim i rrejshëm tregonte se Omer Ibën Hatabi, kalifi i dytë, ka urdhëruar që t'i vihet flakë bibliotekës së vjetër të Aleksandrisë dhe atij i vishet të kishte thënë: Nëse këto libra përmbajnë atë që ekziston në Kur'an, atëherë prej tyre



²² Shih; **"Felsefetu Ibën Ruzhd"**, Bejrut 1982, f.17.

nuk ka dobi dhe nuk kemi nevojë për to. E nëse përmbajnë kundërshtime me Kur'anin, domosdo duhet të asgjësohen. Gjithashtu është thënë se arabët myslimanë, për gjashtë muaj i kanë përdorur librat si lëndë djegëse për banjat publike.

4. Orientalistja gjermane Sigrd Hunke në librin e saj "*Allah ist ganz anders*", sqaron se kur arabët hynë në Aleksandri në vitin 642, në Aleksandri nuk kishte bibliotekë. Ajo ishte djegur shekuj më parë, siç nuk kishte as banja publike. Ajo shpjegon se biblioteka e vjetër e shkollës së Mbretit Ptolemeut të Parë (Soter) e themeluar në vitin 300 p.e.s. është djegur në vitin 47 p.e.s. kur Julius kishte rrethuar qytetin. Bibliotekën e ktheu Kleopatra dhe e furnizoi me libra nga Bergamuni.

5. Shek. III dëshmon fillimin e shkatërrimit të sistemuar të Bibliotekës në Aleksandri. Perandori Caracalla e ka mbyllur Akademinë dhe themeluesit religjioz shkatërruan Bibliotekën gjatë vitit 282 së cilësuar për pagane. Në vitin 319 Patriku Teofilos mori leje nga Perandori Teodosios të shkatërrojë gjithçka që kishte mbetur nga Akademia dhe të djeg atë çfarë kishte ngelur nga librat, e që atë kohë përmbante tre mijë pergamene me qëllim që të ndërtojë kishë dhe manastir në atë vend. Shkatërrimi i bibliotekës është përtërirë në

shek. V gjatë sulmit mbi dijetarët paganë, vendet e tyre të lutjeve dhe bibliotekat.²³

Nga kjo që u tha bëhet e qartë se në ç'masë është bërë falsifikimi i qëllimshëm i historisë me qëllim të shtrembërimit të imazhit të Islamit dhe të myslimanëve, prezantimit të tyre si armiqë të shkencës dhe civilizimit. E myslimanët janë krejt-ësisht larg kësaj.

(IV) CILA ËSHTË E VËRTETA E XHIHADIT NË ISLAM?

1. Është përhapur në gjuhë të huaja se Xhihad d.m.th. Luftë e Shenjtë. Islami nuk njeh shprehjen "Luftë e Shenjtë". Ai njeh luftë legjitime dhe jolegjitime, kurse xhihadi është keqkuptuar në të shumtën e rasteve. "Xhihad" vie nga fjala "Xhuhd" që d.t.th. përforcim i përpjekjeve të skajshme, nga këtu ai ndahet në dy pjesë: E para, xhihadi i nefsit – përpjekja për ta mbrojtur veten, dhe e dyta, përpjekja në luftë ligjore, të drejtë. Është e njohur se lloji i parë emërtohet si Xhihad i Madh, por ai ka të bëjë me luftën që njeriu e bën kundër çdo të keqe, tekave të tija, eliminimin e vetive ne-



²³ Hunke, Sgrid: "Allah ist ganz anders", f.85-90. Lexo gjithashtu: "El Islam fi miraati el fikr el garbij", f. 100 e në vazhdim.

gative, pastrimin nga urrejtja, xhelozia ndaj të tjerëve, me çka ai do të jetë meritore për t'iu afruar Allahut të Lartëmadhërishëm. Kurse lloji i dytë i xhihadit, që nënkupton luftën e ligjshme, emërtohet si Xhihad i Vogël.

Përpjekja e parë e rëndësishme, që është bërë, është quajtur Xhihadi i Madh, sipas të cilit përpjekja që të eliminohet çdo e keqe, prova, dhe të pastrohet shpirti nga veset, veçanërisht nga veset e xhelozisë, zilisë dhe urrejtjes, kurse me të gjithë këtë të arrihet qëllimi, të meritohet të hyhet në mëshirën e Zotit. Forma tjetër e Xhihadit është e njohur si Xhihadi i Vogël, dhe dmth. luftë për ligjin dhe luftë për të drejtën.

2. Lufta e ligjshme në Islam, pra xhihadi, është luftë për mbrojtje, qëllimi i të cilës është dëbimi i sulmit. Ajetet Kur'anore në këtë janë shumë të qarta. Allahu xh.sh. u lejoi myslimanëve të luftojnë armiqtë e tyre nga të cilët janë sulmuar:

“Atyre që po sulmohen me luftë, u lejohej të mbrohen, për shkak se u është bërë padrejtësi.”
(el Haxh:39)

“Luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju luftojnë, por mos kaloni kufirin. Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin.” (el Bekare 190)

Kjo na shpjegojnë se përkundër lejes për luftë në vetëmbrojtje, Kur'ani tërheq vërejtje për tejkalim të kufijve, ngase Ai nuk i do ata të cilët e teprojnë. Urrejtja e Islamit ndaj luftës dhe derdhjes së gjakut paraqet qëndrim parësor, pra lufta është përjashtimi, reaksion kundër sulmit:

“...kush ju sulmon juve, ktheni sulmin atij edhe ju po në atë masë.” (el Bekare:194)

“U është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni.” (el Bekare:216)

Fillimi i sulmit kundër të tjerëve është çështje e rrefuzuar islamisht dhe nuk gjenë mbështetje në Islam.

3. Dhe kur Xhihad do të thotë angazhim për mbrojtje, ai nuk përkufizohet vetëm me luftën, ai mund të jetë përmes pasurisë, opinioneve, ose në çdo mënyrë tjetër, që ndihmon në largimin e armiqësisë me të gjitha format e saja. Qëllimi, pra, është ruajtja e shoqërisë islame, e besimit që është e drejtë ligjore e çdo kombi, të cilat vërtetohen edhe me marrëveshje ndërkombëtare bashkëkohore.

4. Nëse myslimanët gjykojnë se armiqët e tyre dëshirojnë paqe, ndërprerjen e agresionit, Islami obligon myslimanët që t'u përgjigjen me pranim:

“Nëse ata anojnë drejt paqes, ano edhe ti kah ajo dhe mbështetu në Allahun.” (el Enfalë61)

Përveç kësaj, Islami fton në bashkëjetesë paqësore me të tjerët, vendosje të raporteve të mira me ta, përderisa nuk shfaqin armiqësi kundër myslimanëve. Kështu gjejmë se Kur'ani i Madhërishëm kërkon nga myslimanët që ndaj tyre të sillen në bazë të drejtësisë, mirëbërësisë:

“Allahu nuk u ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësi.” (el Mumtehineti:8)

Kjo na bën me dije se qëllimi i Islamit është përhapja e paqes dhe tolerancës mes njerëzve, bashkëpunimit të ndërsjellë në të mirë të njeriut dhe lumturisë së tij.

Nga këtu, ajo që shfaqet nga disa media internationale se Islami është një fe që predikon agresion, ekstremizëm, fanatizëm, luftë dhe terrorizëm, janë shpifje të dëmshme të cilat janë të pabazuara në mësimet islame. Islami është tamam e kundërta e gjithë kësaj, është fe e mëshirës dhe paqes. Në lidhje me këtë pikë do të shtojmë me sqarime në nëntitujt në vazhdim.

(V) A THËRRET ISLAMI NË EKSTREMIZËM DHE DHUNË?

1. Islami është fe e mëshirës, tolerancës, thërret në drejtësi, paqe, mbron lirinë e njeriut dhe dinjitetin e tij. Këto nuk janë thjesht parulla të cilat i ngrit Islami, por ato janë parime esenciale, themele mbi të cilat është ngritur Islami. Allahu xh.sh. e dërgoi të dërguarin e Tij, Muhamedin a.s., ashtu siç na thotë Kur'ani famëlartë:

“...mëshirë për botërat.” (*el Enbija: 107*)

I Dërguari i Allahut e cilëson misionin e tij me fjalët:

“Jam i dërguar për të plotësuar moralin e mirë.”²⁴

Islami i jep njeriut lirinë e të zgjedhurit, qoftë dhe në çështje të besimit:

“Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.” (*el Kehf:29*)

Thirrja për në islam bëhet me bindje, urtësi, këshillë të mirë, polemizim me më të mirën e jo me urrejtje. Islami urdhëron në drejtësi, mirësi dhe ndalon nga të këqijat, zullumin, amoralite-



²⁴ Transmeton Buhariu në Librin *el Edeab el Mufrid*.

tin...²⁵ Thërret në ndërrimin e të keqes me të mirë²⁶ Muhamedi a.s. me rastin e marrjes së Mekës, përkundër të gjithave që kishte përjetuar ai dhe shokët e tij nga mizoritë, torturat dhe vrasjet nga mekasit, ai ua fali dhe u tha:

“Shkoni, jeni të lirë.”

2. Ekziston ujdi e plotë mes Islamit dhe paqes. Islam është nga rrënjë të njëjta të fjalës salam-paqe. Allahu xh.sh. veten e cilëson në Kur'an se Ai është Salam-paqe. Përshëndetja e myslimanëve është selami-paqja, si përkujtim i përhershëm për ta, si qëllimi i tyre kryesor, që nuk guxojnë ta kenë larg kujtesës. Myslimani në fund të namazeve-lutjeve që i kryen pesë herë në ditë, e përfundon me përshëndetjen - selam. Përshëndetje të cilën e jep në dy anët e tija, në të djathtën dhe në të majtën; me çka e përshëndet botën; akt ky që simbolizon se myslimanët janë për sigurinë e paqes për mbarë botën.

3. Shihet qartë se Islami me frymën e saj paqësore nuk lë vend për dhunë, fanatizëm, ekst-



²⁵ **“Vërtetë Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, kurse ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna.”** (en Nahel:90)

²⁶ **“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj (të keqen) ktheje në mënyrë më të mirë, se atëherë ai, me të dlin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.”** (Fussilat:34)

remizëm, terror, kërcënim atyre që janë në siguri, ose të sulmohen jetët e tyre, apo pronat. Qëllimet e sheriatit islam përmbledhen në mbrojtjen e të drejtave thelbësore të njeriut, veçanërisht, mbrojtjen e jetës, fesë, mendjes, familjes dhe pronës së tij. Nga këtu, Islami ndalon çdo lloj atakimi të çdo forme, saqë ai sulmin kundër një personi e konsideron sikur atakohet mbarë njerëzimi:

"...kush e mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, është sikur të kishte mbytur gjithë njerëzimin." (*el Maide*32)

Çdo individ përfaqëson njerëzimin, kurse njerëzimi është ai për të cilin Islami përkushtohet ta mbrojë. Ai prezantohet në respektimin e çdo individi ndaj tjetrit, respektimin e lirisë së tij, dinjitetit, të drejtave të përgjithshme njerëzore. Në një hadith thuhet:

"Myslimanit kundër myslimanit i janë të ndaluara: gjaku, pasuria dhe nderi."²⁷

Sic thuhet në një hadith tjetër:

"Myslimanit nuk i lejohet të kërcënojë një mysliman."²⁸



²⁷ Transmeton Muslimi në Librin *el Bir*.

²⁸ Transmeton Ebu Davudi në Librin *el Edeh*.

Islami thërret në bashkëjetesë, në paqe mes popujve dhe trajtim të jomyslimanëve me drejtësi, siç thotë Kur'ani Fisnik:

"Allahu nuk u ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë, e që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Vërtetë Allahu i do ata që mbajnë drejtësi." (el Mumtehineti:8)

4. Përgjegjësia e ruajtjes së sigurisë së popullatës dhe stabilitetit është përgjegjësi reciproke mes gjithë njerëzve. Kjo përgjegjësi është mënyrë drejt stabilitetit dhe sigurisë në përballje me të ligat dhe degjenerimin. Muhamedi a.s. ka thënë:

"Sikur shembulli i njerëzve të hipur në anije ku di sa të ishin në katin e sipërm e di sa të ishin në të poshtmin. Ata që ishin poshtë, për ujë hipnin në katin e sipërm. Kështu thanë: Të hapim një vrimë për nevojat tona dhe mos t'i bezdisim ata që janë lart. Sikur ata që ishin lart t'i lejonin të bënin këtë, do të shkatërroheshin që të gjithë, e sikur t'i ndalonin, do të shpëtonin që të gjithë."²⁹



²⁹ Transmeton Buhariu në Librin *esh Sherike*

(VI) CILI ËSHTË QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ FANATIZMIT DHE TERRORIZMIT?

1. Islami është fe që absolutisht nuk njeh fanatizëm. Burimet e tij, Kur'ani Fisnik dhe Suneti i Muhamedit a.s. nuk përmbajnë diçka të atillë, pra nuk thërrasin në fanatizëm.

Thirrja në Islam – siç na sinjalizon Kur'ani Famëlartë, bazohet mbi urtësinë, këshillën e mirë dhe dialogun me të mirë, e këto metoda janë plotësisht larg pra nga çdo formë e fanatizmit. Nga këtu, me që mosbesimtarët mekas mohuan thirrjen e tij, Pejgamberi a.s. u tha:

“Ju e keni fenë tuaj, e unë kam fenë time.” (*el Kafirunë6*)

2. Kurse në lidhje me fetë e mëparshme, Islami besimin mbi pejgamberët, para Muhamedit a.s., e konsideron element esencial të besimit të myslimanit. Këtë Kur'ani Fisnik e thotë me qartësi të plotë:

“Ju thuani: Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve, në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe atë që i është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve. Nuk bëjmë

dallim në asnjërin prej tyre dhe vetëm atij i jemi bindur." (*el Bekare:136*)

Pra, qëndrimi Islam ndaj gjithë pejgamberëve është mosbërja dallim mes ndonjërit prej tyre. Këtë formë të tolerancës nuk mund ta gjesësh në asnjë fe tjetër, e si mund pas kësaj të ketë hapësirë për fanatizëm, të çfarëdo forme qoftë ai, në mësimet e një feje të kësaj cilësie.

3. Islami fton të gjithë njerëzit në bashkim, të njihen mes vete, përkundër dallimeve midis tyre:

"O njerëz! Ne vërtet ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni mes vete." (*el Huxhuratë:13*)

Ngjashëm me këtë, Islami i fton ithtarët e tij hapur dhe qartë për bashkëjetesë paqësore me jomyslimanët. Kur'ani Fisnik thotë:

"Allahu nuk u ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë, e që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Vërtetë Allahu i do ata që mbajnë drejtësi." (*el Mumtehineti:8*)

4. Islami është fe e cila thërret në pajtim dhe falje:

"..të falni është më afër devotshmërisë." (el Bekare 237)

Thërret që me mirësi të përballemi me të keqën, me shpresë që armiku të kthehet në mik:

"Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj (të keqen) ktheje në mënyrë më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt." (Fussilet:34)

5. Në një hadith të Muhamedit a.s. thuhet:

"Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos ngushtoni."³⁰

Kjo është thirrje për eliminimin e fanatizmit, ngase ngushtimi nisët nga fanatizmi, kurse përgëzimi nga toleranca. E kur Islami e hedh fanatizmin, nga këtu ai e refuzon terrorin, ekstremizmin, frikësimin e atyre që janë në siguri dhe vrasjen e të tjerëve. Në të vërtetë, Islami e konsideron sulmin ndaj një njeriu si sulm ndaj tërë njerëzimit:

"...kush e mbyl një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, është sikur të kishte mbytur gjithë njerëzimin." (el Maide 32)



³⁰ Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

6. Nga kjo që u tha bëhet e qartë se akuza për fanatizëm që i bëhet Islamit, nuk është e bazuar, nuk ka asnjë mbështetje në mësimet islame. E nëse ndër myslimanët ka disa fanatikë, ekstremistë me të cilët nuk veçohen vetëm pjesëtarë të një feje, kjo është një e vërtetë që në botën bashkëkohore po prezantohet para syve të të gjithëve, në asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me mësimet islame, por me njohje të gabueshme, interpretime të shtrembëruara të mësimave islame. Islami pra nuk bartë diçka të atillë.

Duhet të bëhet dallim mes mësimave të larta islame dhe sjelljeve të gabuara të disa myslimanëve. Nga ana tjetër, fanatizmi ekziston te disa gupacione në çdo fe, terrorizmi gjithashtu është bërë fenomen botëror me të cilin nuk veçohen vetëm ithtarë të një feje. Atëherë, vallë Islami është ajo fe e cila nxorri këtë fenomen në mesin e ithtarëve të të gjitha feve?

KREU I KATËRT



ISLAMI DHE ÇËSHTJET E NJERIUT

(I) CILA ËSHTË E VËRTETA E LIDHSHMËRISË MES ALLAHUT DHE NJERIUT?

1. Allahu xh.sh. e ka krijuar njeriun dhe e ka vendosur atë si zëvendës të tij në Tokë, në dobi të tij ia nënshtroi atij universin, qiellin, tokën dhe gjithë atë që është midis tyre, duke kërkuar nga ai zhvillim. Kjo tregon se Allahu ka dashur që njeriu të jetë zotëri i tokës, por njëkohësisht të mos harrojë se Zoti është ai që e ka krijuar. Në këtë kuptim vetë ai, është shërbëtor i Zotit, dhe pritët nga ai që t'i shërbejë Krijuesit të vetë, si adhurues i Tij, por jo si adhurues robërues, ose rob i gjorë. Gjithëfuqishmëria e Zotit i ka dhënë njeriut liri të zgjedhjes midis asaj t'i nënshtrohet Zotit, ose të bëhet i padëgjueshëm ndaj Tij, midis asaj të besojë në Atë ose ta rrefuzojë besimin e Tij, e gjithë kjo është pasqyruar në ajetin:

“Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.” (el Kehf: 29)

Liria e zgjedhjes është e kundërt me robërimin. Njeriu gjithmonë është në pozitën e zgjedhjes, së këndejmi ai është përgjegjës për sjelljet e tij:

“Kush bën mirë, bën për vete, e kush bën keq, bën kundër vetes, pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.” (*el Xhathije*:15)

2. Allahu xh.sh. nderoi njeriun, e vlerësoi mbi qeniet e tjera që krijoi – siç na njofton Kur’ani Fisnik:

“Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)..” (*Isra*:70)

Ky nderë me të cilin Allahu xh.sh. bekoi njeriun, është në kundërshtim të plotë me robërinë. Allahu xh.sh. me rastin e krijimit të njeriut, dhe kur Zoti e ka krijuar njeriun, në të fryu nga shpirti i Tij dhe obligoi melekët – engjujtë për sexhde – përkulje:

“E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t’i japë atij shpirtin që është krijesë e Imja, atëherë ju bini atij në sexhde.” (*Hixhë*:29)

Në këtë proces të gjallërimit shpirtëror hyjnor, qëndron lidhshmëria e afërt mes Allahut dhe

njeriut. Çdo individ në brendinë e tij bartë diçka nga ajo frymë hyjnore përmes të cilës ndjenë se Krijuesi është me të në çdo kohë dhe vend:

“Ai është me ju kudo që të jeni..” (el Hadid:4)

3. Kur'ani Fisnik na mëson se Allahu fuqiplotë është më afër njeriut se damari i qafës së tij,³¹ se është afër dhe i përgjigjet lutjeve të atij që lutet,³² se është Mëshirëbërës, Mëshirëplotë dhe më i Mëshirshmi i Mëshiruesve mëshira e të Cilit përfshinë çdo gjë.³³ Edhe pse në Kur'anin Fisnik i Lartmadhërishmi është përmendur një herë si Impounues, dy herë si Mbizotërues, gjashtë herë si Ngadhnjimar, Ai është përshkruar në Kur'an si Mëshirëplotë pesëdhjetë e shtatë herë, si Mëshirëbërës njëqind e pesëmbëdhjetë herë, gjithashtu edhe njëqind e trembdhjetë herë në besmelet në fillim të sureve Kur'anore ku përshkruhet si Mëshirëbërës dhe Mëshirëplotë. I Lartmadhërishmi gjithashtu në Kur'an përmendet edhe katër herë si më i Mëshirshmi, dhjetë herë si Përdëllimar dhe shumë herë përmendet mëshira e Tij, me çka vihet në dukje se lidhshmëria intime midis njeri-



³¹ “Ne e kemi krijuar njeriun dhe e dimë se ç’pëshpëritë ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.” (Kaf:16)

³² “E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet.” (el Bekare 186)

³³ “Mëshira ime ka përfshirë çdo gjë.” (el A'raf:156)

ut dhe krijuesit të tij është lidhshmëri e afërsisë, mëshirës, përgjigjes në lutje. Allahu xh.sh. është më i mëshirshëm me krijesën e vet se sa nëna ndaj fëmijës së vetë. Kësisoj ndjenë çdo mysliman në brendinë e tij.

(II) CILI ËSHTË QËNDRIMI I ISLAMIT MBI MENDJEN (ARSYEN) E NJERIUT?

1. Islami është feja e vetme që e lartësoi statusin e mendjes së njeriut dhe e proklamoi rëndësinë e saj. Mendja e njeriut është kushtëzimi për t'u obliguar njeriu dhe për të marrë përgjegjësi. Përmes mendjes ai njeh Krijuesin e tij, percepton misteret e krijimit dhe madhësitinë e Krijuesit. Kur'ani Fisnik në ligjërim të njeriut, i drejtohet mendjes, e nxitë atë të mendojë për universin, të meditojë, të studiojë për të mirën e njerëzimit. Në fenë islame nuk ka diçka që kundërshton mendjen ose një opinion të shëndoshë ose të vërtetat shkencore.

2. Islami kërkon domosdoshmërinë e shfrytëzimit të mendjes dhe qorton ata që nuk angazhojnë mjetet e perceptimit në kreun e së cilave për kryerjen e detyrës së saj është mendja. Së këndejmi, të atillët Kur'ani Fisnik i konsideron se kanë hequr dorë nga vlerat njerëzore:

"...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy që me ta nuk shohin dhe kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, këta janë ata të shkujdesurit." (el Araf:179)

Mosshfrytëzimin e mendjes Kur'ani Famëlartë e ka konsideruar mëkat nga mëkatet dhe ka përshkruar se çfarë do t'u thuhet mohuesve ditën e kiametit:

" Dhe thonë: Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit." (el Mulk:10)

3. Islami tërheq vëmendjen e njeriut drejt faktit se Allahu fuqiplotë i ka nënshtruar atij gjithësinë dhe se obligimi i tij është shfrytëzimi i mendjes për mirëqenie të njerëzimit dhe ndërtimit të tokës:

"Ai u krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij." (Hudë61)

"Dhe për ju nënshtroi gjithë ç'ka në qiell dhe ç'ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë thellë, në to ekzistojnë argumente." (el Xhathije13)

Andaj, e gjithë gjithësia është fushë e logjikës njerëzore, të angazhohet për mirëqenien e njerëzimit dhe nxit në gjithçka që njerëzve u sjell dobi.

4. Tekstet – burimet fetare në Islam në lidhje me besimin dhe dispozitat fetare janë të domosdoshme për myslimanin. Por, myslimani është i lirë për të menduar, për përsiatje, hulumtim mbi çështje të kësaj bote. Në këtë drejtim këshilloi Pejgamberi a.s. kur ka thënë:

"Ju jeni më të dijshëm në çështje të kësaj bote."³⁴

Hapësira e lirisë së të menduarit, hulumtimit shkencor në Islam është e gjerë dhe e garantuar për njeriun. Në këtë çështje vetëm se nuk bën që të shkelet në çështje të shenjta fetare. Çdo fe krenohet me të shenjtat që posedon, kurse tentativat për të shkelur mbi to, para së gjithash tekstet fetare sikurse që janë shpallja e Kur'anit dhe hadithet e vërteta - autentike. Në këto burime, në asnjë lloj forme nuk mund të ndërhyhet me qëllim që të ndryshohet, shtrembërohet, shtohet, mënjanohet ose të përqeshet diçka. Angazhimet e këtilla nuk mbajnë, janë kundër rendit të përgjithshëm në shoqëri dhe njëkohësisht edhe mëkat fetar. Kurse angazhimi në gjithçka tjetër, në sfera të tjera, e në tërë universin, në tokën,



³⁴ Transmetoi Muslimi në Librin e *el Fadail*.

qiellin e çfarë ka mes tyre, ka hapësirë të pakufishme për arsyen njerëzore për të hulumtuar, studiuar, zbuluar e shpikur.

(III) A ËSHTË E VËRTETË SE ISLAMI THËRRET NË FATALIZËM³⁵?

1. Secili që persiat mbi ajetet e Kur'anit Fisnik do të përforcoj bindjen se Islami nxit për punë dhe drejton nga puna. Puna është jeta. Pa punë, jeta pushon së ekzistuari. Nga këtu në shumë ajete të Kur'anit Fisnik besimi është i lidhur me veprat e mira. Nën veprat e mira nënkuptojnë çdo vepër të mirë të kryer nga njeriu, qoftë ajo fetare ose e natyrës tjetër, përderisa vepra kryhet për hir të Allahut, për t'i kontribuar njerëzimit, për eliminimin e të keqes prej saj. Urdhri për punë është i qartë:

"Dhe thuaj: "Punoni, Allahu do ta shohë punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët". (et Teube 105)



³⁵ Nën termin fatalizëm këtu nënkuptojmë një pikëpamje religjioze sipas së cilës gjërat ndodhin në mënyrë të domosdoshme, pra pikëpamje e cila trajton njeriun si qenie pa ndikim. Kjo pikëpamje është arsyetim i përtacëve të cilët nuk respektojnë normat apo rregullat e duhura të cilat sjellin rezultate. (Shënim i përkthyesit)

Madje Kur'ani Fisnik nxit njerëzit që të punojnë edhe ditët e premtë, ditë kjo e pushimit për myslimanët:

" E kur të kryhet namazi (namazi i xhumasë), atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por edhe përmendeni shpeshherë Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim." (el Xhum'a:10)

2. Pejgamberi a.s. rekomandon punën qoftë dhe në momentet e fundit të jetës dhe botës. Në lidhje me këtë, ai ka thënë:

"Kur të ndodh momenti i fundit (dita kur do të ndodhë kiameti), e në dorën e ndonjërit prej jush ka një fidan, nëse ia arrin, le ta mbjellë atë."³⁶

Muhamedi a.s. gjithashtu, ka refuzuar që disa njerëz të ndahen vetëm për ibadet në xhami dhe për ushqimin e tyre të mbështeten në mundin e të tjerëve; ai lavdëroi atë që punon dhe ushqehet nga puna që e bënë me duartë e veta. Ai lavdëroi dorën punëtore duke thënë se ajo është një dorë të cilën e do Allahu xh.sh. dhe i Dërguari i Tij.

3. Muhamedi a.s. është shembull për myslimanët, sikurse që është shkruar në Kur'an, ka praktikuar të punojë, të planifikojë, të përsiatë dhe të përgatitë gjithçka që ishte e nevojshme për



³⁶ Transmetoi Ahmedi në Musnedin e tij, Vëll.III, f.191.

njerëzit dhe pastaj të mbështetet në Allahun fuqiptotë. Pra, mbështetja në Allahun nuk d.m.th. të mos punohet, por ajo paraqet hapin e fundit, pasi të ndërmerren që të gjitha.

Mbështetja në Allahun nënkupton përkujtimin e Tij, plotësimin shpirtëror që shton fuqinë për tejkalimin e vështirësive, përballimin e problemeve me vendosmëri.

Mbështetja në Allahun, pra është një fuqi pozitive, nuk mund të jetë negative, ose pasive.

4. Me fatalizmin kemi mospërgatitje dhe mosangazhim me pretekstin se Allahu do të veprojë sipas vullnetit të Tij. Këtë Islami e rrefuzon. Allahu xh.sh. nuk ndihmon një njeri i cili nuk ndihmon vetvetën. Ai është me atë që punon:

"Allahu kurrë nuk do ta ndryshojë gjendjen e një populli përderisa ata vet nuk e ndryshojnë". (e Ra'd:11)

Omer Ibën Hatabi ka përzënë disa që ishin nga parazitët dhe që ishin përcaktuar të qëndrojnë vetëm në xhami për ibadet, e në anën tjetër, të varur nga të tjerët për jetë. Ai i urdhëroi dhe u tha fjalën e tij të njohur: *"Sigurisht se qielli nuk lëshon arin dhe as argjendin."*

Ai e ka mbështetur deklaratën e vet me rrëfimin e një nga hadithet e të Dërguarit a.s i cili ka thënë:

"Nëse i mbështeteni Allahut me mbështetje të drejtë, furrnizimi i juaj do të jetë sikur i zogjve, në mëngjes shkojnë me kthetra të zbraztë, nga fundi i ditës kthehen me kthetra të mbushur."

Pra punoni dhe merrni mësim nga zogjtë që çdo mëngjes barkshprazur shkojnë në kërkimin e ushqimit dhe nga fundi i ditës kthehen të ngopura.

(IV) CILI ËSHTË QËNDRIMI I ISLAMIT NË LIDHJE ME DEMOKRACINË DHE TË DREJTAT E NJERIUT?

1. Islami ishte feja e parë që thirri në të drejtat e njeriut, duke nënvizuar domosdoshmërinë e mbrojtjes së tyre. Çdo studiues i Legjislacionit Islam – shariatit, mëson se ky ligj ka për qëllim; mbrojtjen e jetës së njeriut, fesë, mendjes, pasurisë dhe familjes së tij. Historia e Islamit ka shënuar qëndrimin vendimtar të Omer Ibën Hatabit kundër shkeljes së të drejtave të njeriut. Fjala e tij e njohur në këtë thotë: *"Përse i nënshtroni njerëzit, kur nënat e tyre i kanë lindur si të lirë?"*

2. Të drejtat e njeriut në Islam bazohen mbi dy parime themelore:

- a) Barazi midis të gjithë njerëzve
- b) Liri, që është e drejt e çdo njeriu

Parimi i barazisë qëndron mbi dy themele qenësore; origjinën e përbashkët dhe dinjitetin për çdo njeri.

Në lidhje me origjinën, Islami deklaron se Zoti e ka krijuar njerëzimin nga një shpirt dhe nga këtu të gjithë njerëzit janë vëllezër dhe motra në një familje të madhe ku nuk ka hapësirë për shtresa të privilegjuara. Dallimet mes njerëzve nuk prekin brendësinë e njeriut, andaj nga këtu, ashtu siç mësojmë nga Kur'ani Fisnik, ato duhet të na nxisin për t'u njohur, bashkuar dhe bashkëpunuar mes vete e jo pikënisje për konflikte:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete.." (el Huxhurat:13)

Kurse themeli i dytë i barazisë, pra dinjiteti njerëzor, për të cilën Kur'ani e thotë:

"Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)." (el Isra':70)

Allahu xh.sh. e nderoi njeriun duke e caktuar atë si zëvendës të tij në tokë, i bënë sexhde melakët e Tij, bëri që të jetë zot i kësaj toke dhe i nënshtroi ç'ka në qiej dhe në tokë. Njeriu me këto,

pra gëzon një pozitë të lartë nga të gjitha krijesat e tjera. E këtë privilegj Zoti ua mundësoi të gjithë njerëzve, pa përjashtim, nuk ka dallim mes të pasurit dhe të varfrit, atij që ka pushtet nga ai që nuk ka, që të gjithë para Allahut, ligjit dhe të drejtave të përgjithshme janë të barabartë.

Sa i përket parimit të dytë, pra atij të lirisë, Allahu xh.sh. bëri që njeriu të jetë i obliguar dhe përgjegjës për ngritjen e civilizimit njerëzor. Kurse përgjegjësi nuk mund të ketë pa pasur liri, madje edhe çështjen e besimit dhe mosbesimit Allahu xh.sh. e caktoi të jetë e lidhur me dëshirën e njeriut:

“Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.” (*el Kəhf:29*)

Kështu pra liria përfshinë të gjitha aspektet e lirisë së njeriut, ato religjioze, politike, intelektuale ose qytetare.

3. Gjykimi sipas mësimëve Islame, patjetër të bëhet në bazë të drejtësisë dhe konsultimit. Allahu xh.sh. urdhëron njerëzit në Kur'an për drejtësi dhe kërkon të praktikohet ajo:

“Vërtet Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit...” (*en Nahël:90*)

“...dhe kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi.” (en Nisa:58)

*Shura*³⁷ - konsultimi është një parim esencial i domosdoshëm. Muhamedi a.s. konsultohet me sahabët e tij dhe vendoste sipas shumicës, qoftë kur mendimi i tyre ishte në kundërshtim me të tijin. Një gjë e këtillë duket në rastin e betejës së Uhudit, i Dërguari i Allahut xh.sh. nuk ishte i mendimit që beteja të zhvillohet jashtë qytetit, mirëpo shumica ishin për të dalur, kështu edhe ndodhi, por përjetuan disfatë. Përveç kësaj, Kur'ani e thekson domosdoshmërinë e konsultimit dhe i ligjëron të Dërguarit a.s. përmes këtij ajeti:

“...andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta për çështjet. ” (Ali Imran:159)

Sipas kësaj, ne s'guxojmë të mashtrohemi nga mendimi i mbështetur nga pakica e juristëve, të cilët pohojnë se konsultimi nuk është obligues, kurse përveç kësaj, mendimi i tyre është jo konsekuent me Kur'anin Fisnik dhe me Sunetin – traditën e Pejgamberit a.s.



³⁷ *Shura* është një proces konsultativ për vendimmarrje. (Shenim i përkthyesit)

Islami myslimanëve u lejoi vet të zgjedhin formën e konsultimeve në ujdi me interesat e përgjithshme. Nëse është interesi që ajo të jetë në formën që sot e njohim në shtetet moderne, Islami nuk e kundërshton atë. E rëndësishmja është praktiki-mi i shëndoshë me fleksibilitet, në ujdi me rrethanat e kohës.

Nga këtu bëhet e qartë se në çfarë mase Islami mbron të drejtat e njeriut, kujdesin që ka në apli-kimin e shëndoshë të parimit të shurasë, ose de-mokracisë në kuptimin bashkëkohor.

4. Islami i jep shans pluralizmit të mendimeve, lejoi *ixhtihadin*³⁸ edhe për çështjet religjioze me atë që *muxhtehidi* të ketë plotësuar kushtet e ixhtiha-dit. Kështu për një muxhtehid, i cili angazhohet edhe nëse gabon, ai ka një shpërblim, kurse për atë që angazhohet dhe e qëllon, ka dy shpërblime.

Studiuesit e medhhebeve – drejtimeve të së drejtës islame gjejnë që mes tyre të ketë dallime në mendime në shumë çështje, e askush prej tyre nuk thotë se kjo është e palejuar. Pra Islami i jep ha-pësirë mendimit tjetër, për të shprehur lirshëm atë që mendon përderisa qëllimi i tyre është e mira e shoqërisë, mbrojtja e sigurisë dhe e stabilitetit.



³⁸ Angazhimi maksimal i një alimi-dijetari për të arritur deri në një zgjidhje të mundshme në ndonjë çështje duke u bazuar në burimet e legjislacionit islam. Kurse muxhtehid quhet ai i cili merret me ixhtihad. (Shënim i përkthyesit)

(V) CILI ËSHTË QËNDRIMI I ISLAMIT LIDHUR ME ARTIN?

1. Islami është fe që e don bukurinë dhe thërr-et në të. Vet Muhamedi a.s. ka deklaruar:

“Allahu është i bukur dhe e do bukurinë.”³⁹

Arti është një krijimtari e bukur, që Islami nuk e kundërshton. E rëndësishme është se Islami i jepë prioritet parimit të moralit ndaj atij të bukurisë, pra ky është qëndrimi parimor islam ndaj të gjitha llojeve të artit. Ekziston një kriter islam për të gjykuar në lidhje me ndonjë lloj arti, ai thotë “*e mira e saj është e mirë, e liga është e ligë*”

Kur’ani Fisnik në shumë ajete e tërheq vëmendjen tonë për bukurinë e gjithësisë dhe perfeksionimin e krijimit të saj, bukuri që, pa mëdyshje, mahnisin.⁴⁰ Nga këtu, nuk është e logjikshme që Islami të mos pranojë artin, nëse ai është i bukur, por nëse ai përmban atë që është e ligë, qoft material ose moral, Islami nuk pajtohet me të.



³⁹ Transmetoi Muslimi në Librin *El Iman*.

⁴⁰ “Ne, në qiell kemi krijuar galaksione yjesh dhe atë (qiellin) e kemi zbukuruar për ata që e sikojnë me vëmendje.” (*el Hixhër: 16*)
 “Në to (në kafshët) ju shihni hijeshi kur në mbrëmje ato i ktheni dhe kur në mëngjes i lëshoni.” (*en Nahël: 6*)
 “...Qieillin më të afërt Ne e stolisëm me yje ndiqëse...”
 (*Fussilet: 12*)

2. Nga kjo që u tha deri më tani shihet se, nëse qëllimi i artit është kënaqësia mendore, lehtësimi, korigjimi i ndjenjave, natyrisht se Islami nuk e kundërshton. Mirëpo, nëse ligjëron instinktët trupore të njeriut dhe tejkalon kufijtë e të qenit art, atëherë ai nuk ndihmon në ndërtimin e jetës por në rrënimin e së njëjtës duke u shndërruar në dëfrim diskreditues e kotësi e rrefuzuar, çështje që Islami nuk i pranon.

3. Nëse muzika dhe kënga na bartin fjalë të fisnikëruara, melodi të harmonizuar, zë të bukur, përderisa ato janë brenda kornizës së parimit të moralit, Islami nuk i ndalon, ngase arti synon që t'i lartësojë emocionet dhe shpirtin e njeriut.

I Dërguari a.s. entuziazmohej nga zëri i Ebu Musa El Eshariut kur këndonte Kur'an. Muhamedi a.s. ka zgjedhur nga sahabet e tij për thirrjen e ezanit ata që ishin me zëra të bukur. Ai gjithashtu, i ka dëgjuar instrumentet muzikore, sikurse që janë: defi dhe gajdeja, duke mos dhënë vërejtje se ndalohen.

Kurse në një ditë feste, Ebu Bekri kishte hyrë në shtëpinë e të bijës së tij Ajshes r.a., bashkëshortes së Muhamedit a.s. dhe tek ajo dëgjoji se si po këndojnë dy shërbëtore, duke i rënë defave, dhe kishte reaguar, mirëpo Muhamedi a.s. i është përgjigjur reagimit të tij duke thënë:

*"Lëri ato dyja Ebu Bekër, jemi në ditët e festës."*⁴¹

Muhamedi a.s. gjithashtu e porositi Ajshen r.a. që të dërgojë dikë për të kënduar në dasmën e një të afërme të saj, që martohej me një njeri nga ensarët – nga banorët e Medinës.

Ekzistojnë edhe disa transmetime të tjera nga Pejgamberi a.s. përmes së cilave bëhet e qartë se këndimi dhe muzika nuk janë të ndaluara nëse nuk janë të shoqëruara me elemente jo të hijshme dhe jomorale.⁴²

4. Në lidhje me vallëzimin, Islami bën dallime midis vallëzimit të meshkujve dhe atij të femrave. P.sh. vallëzimi popullor i meshkujve është i lejuar. I Dërguari a.s. i lejoi gruas së tij Ajshës, ta shikojë grupin e Abesinitëve që vallëzonte në ditë feste.

Vallëzimi i femrave para femrave tjera është e lejuar, kurse Islami nuk e miraton vallëzimin e gruas para meshkujve.

5. Sa i përket aktrimit, nuk është i ndaluar përderisa është brenda suazave të parimit të moralit. Askush s'mund ta mohojë rolin e qenësishëm që



⁴¹ Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

⁴² El Kardavi, Jusuf: *"El Halalu vel Haramu"*, f.291 etj. Doha-Katar 1978; El Gazali, Muhamed: *"Miet sual fi el Islam"*, Vëll.I, f.174, etj.

ka në trajtimin dhe eliminimin e shumë problemeve dhe fenomeneve negative në shoqëri.

Nuk prishë punë edhe sikur aktrimi të përmbante edhe ndonjë formë të zbavitjes së hijshme që nuk i tejkalon kufijtë e mirësjelljes.

Kështu është edhe me fotografimin, që sot në jetën tonë bashkëkohore është bërë edhe domosdoshmëri.

6. Kurse sa i përket statujave, ekzistojnë tekste të qarta që ndalojnë. Arsyeja për këtë ndalim del nga ajo që njerëzit mund të adhurojnë të njëjtat, ashtu pra sikur më parë bënë idhujtarët. Sikur të mos ekzistonte mundësia për diçka të këtillë, duke u mbështetur në vetëdijesimin e njerëzve, nuk do të kishte dëm prej tyre, e as arsye për ndalim. Mirëpo, Islami nuk dëshiron të hapë këtë portë, duke pasur për qëllim që përmes ndalimit të reagohet në preventivë. Islami ka vendosur rregullat e veta, ngase ajo që neve mund të na duket se është e pamundur për një epokë, më herët ose më vonë mund të bëhet nga të mundshmet.

KREU I PESTË

ISLAMI MBI POZITËN E GRUAS

(I) A ËSHTË E VËRTETË SE ISLAMI DISKRIMINON GRUAN DHE PRIVON TË DREJTAT E SAJA ?

1. Në kohën kur u shfaq Islami, gjendja në të cilën jetonte gruaja ishte e keqe. Gruaja nuk kishte ndonjë të drejtë që i respektohej e as që dëgjohej mendimi i saj. Islami e ngriti atë nga gjendja në të cilën ishte, dëboi nga ajo shumë padrejtësi me të cilat ballafaqohej dhe bëri që ajo të ndjehet si qenie njerëzore, e barabartë me burrin. Islami garantoj të drejtat ligjore, hodhi poshtë akuzën e fajësisë së saj në gabimin e Ademit a.s. në xhenet, duke e cilësuar gruan si burimi i së keqes në botë dhe shpjegoi se shejtani – djalli është ai i cili mashtroi edhe Ademin a.s. edhe Havën, siç thotë Kur'ani Fisnik:

“Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin.” (*el Bekare* 36)

2. Islami e ka theksuar faktin se i gjithë njerëzimi, burrat dhe gratë janë krijuar nga i njëjti shpirt:

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju krijoi prej një njeriu dhe nga ai krijoi palën (shoqen e tij).” (en Nisa:1)

Burri dhe gruaja janë plotësisht të barabartë si qenie njerëzore, asnjëri prej tyre nuk është i privilegjuar, siç nuk janë të dalluar as në nderin që Allahu xh.sh. u ka dhënë. Në Kur'an thuhet:

“Ne vërtetë nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzimin).” (el Israaë 70)

Ky nderë është në mënyrë të barabartë edhe për burrin edhe për gruan. Kur në Kur'anin Fisnik hasim në fjalët **“njeri”** ose **“bijë të Ademit”**, qëllimi është edhe për burrin edhe për gruan. Kurse në rastet kur bëhet fjalë vetëm për njërin nga gjinitë, atëherë përdoret terminologjia **“burrat”** dhe **“gratë”**.

3. Muhamedi a.s. e ka përshkruar lidhjen midis burrit dhe gruas duke u shprehur me këto fjalë:

“Gratë janë motrat e burrave, kanë të drejta të njëjta, sikurse që kanë përgjegjësi të njëjta.”⁴³

Kjo na shpjegon neve barazinë, pra, burri dhe gruaja janë të barabartë para Allahut të Madhërishëm nuk ka dallim mes tyre, pos nga aspekti i



⁴³ Transmetoi Ebu Davudi, et Tahare Vëll.I, f.61.

veprave të mira të cilat prezantojnë, siç na sinjalizon në këtë edhe ajeti fisnik:

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë, e do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (en Nahël:97)

Allahu xh.sh. u përgjigjet lutjeve të gruas ashtu siç i përgjigjet lutjeve të burrit dhe askujt nuk ia mohon veprën e mirë, siç thuhet në Kur'anin Fisnik:

“Zoti i tyre iu përgjigjet lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humbë mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri.” (Ali Imran:195)

Shprehja kur'anore: **“Ju jeni njëri nga tjetri”** argumenton se secili prej tyre plotësojnë njëritjetrin dhe se jeta nuk mund të jetë e qëndrueshme pa bashkëpunimin e tyre mes vete.

4. Pas këtij qëndrimi parësor të Islamit ndaj gruas, përmes teksteve autentike nga burimet e Islamit – Kur'anit dhe Sunetit – a ka mundësi që dikush të akuzojë për shtypje dhe privim të drejtave të gruas? Në fakt, këtu bëhet një përzierje e

padrejtë mes Islamit si fe, principeve të saja të larta dhe fisnike me adete, tradita dhe sjellje të këqija të disa myslimanëve ndaj gruas. Gjykimi objektiv për Islamin dhe qëndrimin e tij, kërkon të bëhet dallim mes këtyre dy çështjeve. Pozita e ulët e gruas në disa shoqëri islame ka të bëjë me injorancën e përhapur në ato shoqëri dhe nuk është pasojë e normave islame.

(II) A ËSHTË GJITHNJË GRUAJA E NËNSHTRUAR BURRIT?

1. Islami i dha gruas pavarësi të plotë financiare, ajo posedon liri absolute në pronën e saj; të blejë, të shesë, të dhurojë, të investojë etj. pa marrë leje nga bashkëshorti i saj. Në anën tjetër, askush nuk ka të drejtë të shfrytëzojë diçka nga pasuria e saj pa lejen e saj, pra as bashkëshorti dhe të afërmit e saj.

2. Burrit nuk i lejohet, qoftë edhe prind, ta detyrojë të bijën e vet në martesë me ndonjë që nuk e donë, pra martesa domosdoshmërisht të jetë me pajtimin dhe pëlqimin e saj.

Një herë një vajzë shkoi te Muhamedi a.s. për t'u ankuar nga shkakun se babai i saj ka dashur që ta martojë me një djalë të një të afërmi të tij për

qëllime të ngritjes së pozitës së vet, por ajo nuk e donte atë djalë. Muhamedi a.s. e thirri babain e vajzës dhe në prani të babait të saj i tha se është e drejtë e saj ta pranojë atë lidhje kurore ose ta refuzojë. Mirëpo vajza vendosi të pranonte martesën dhe tha: "O i Dërguar i Zotit! Tani lejoj atë që babai im e dëshironte, mirëpo unë desha t'i mësojë gratë se në këtë çështje prindërit nuk kanë të drejtë vendosjeje."⁴⁴ D.m.th. ata nuk kanë pushtet për të detyruar vajzat e tyre në martesë.

3. Gruaja është partner i burrit në familje dhe në edukimin e fëmijëve të tyre. Asnjë familje nuk mund të jetë e qëndrueshme pa bashkëpunim pozitiv nga ana e të dyve, në të kundërtën, humbet baraspesha familjare dhe kjo reflekton ndikim negativ te fëmijët. I Dërguari i Allahut xh.sh. vë në dukje se përgjegjësia e familjes është e përbashkët, pra edhe për burrin edhe për gruan kur tha:

"Të gjithë ju jeni barinj dhe çdonjëri prej jush është përgjegjës për tufën e tij. Babai është bari për shtëpinë dhe familjen e tij dhe është përgjegjës për tufën që ka. Edhe nëna është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe është bareshë për tufën e saj."⁴⁵



⁴⁴ Transmetoi Buhariu në librin *en Nikah*.

⁴⁵ Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

Fakti se gruas i është dhënë përgjegjësi, plotësisht mohon akuzën se ajo është e nënshtruar. Nuk mund të ketë përgjegjësi pa pasur liri, kurse liria nuk lejon nënshtrimin.

4. Asnjë burrë nuk ka të drejtë që gruas t'ia cenjë të drejtën ndaj praktikimit të të drejtave të saja ligjore në jetë, e as që ka të drejtë t'ia ndalojë asaj shkuarjen në xhami për ibadet. Në lidhje me këtë transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Mos ua ndaloni grave që të luten në xhami.”⁴⁶

Nëse disa myslimanë në bazë të disa traditave dhe adeteve të këqija nuk i përmbahen këtyre qëndrimeve islame lidhur me gruan, kjo nënkupton mosnjohjen ose keqperceptimin e Islamit, normave dhe mësimave të tija të qarta.

(III) PËRSE NË TRASHËGIMI GRUAS I TAKON MË PAK SE BURRIT?

1. Në periudhën paraislame gratë kanë qenë të privuara nga e drejta e trashëgimisë. Me ardhjen e Islamit atyre u caktua e drejta në trashëgimi përkundër kundërshtimeve nga shumica e arabëve atëkohë, të cilët kishin bindjen se e drejta për trashëgimi duhet të jetë vetëm për burrat, pasi që ata ishin që bënë luftën me armiqtë e tyre.



⁴⁶ Transmetoi Ibën Maxhe, Vëll.I, f.8.

Islami në disa raste ka caktuar që mashkullit nga trashëgimia t'i ndahet hise sa për dy femra, siç thuhet në Kur'anin Fisnik:

“Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra.” (en Nisae 11)

Një vështrim i përshpejtuar mund të konsiderojë se kemi të bëjmë me degradim të gruas, shkelje të së drejtës së saj si njeri që ka të drejta të barabarta me burrin. Realiteti është se Islami është shumë larg kësaj që kjo të jetë arsye që gruaja të shikohet në formë nënçmuese. Shkaku i këtij dallimi në trashëgimi absolutisht nuk ka lidhje me pozitën, as të burrit e as të gruas, por ka të bëjë me obligimet, të cilat bien mbi supet e secilit prej tyre.

2. Islami obligon burrin me përgjegjësi financiare për gruan e vet dhe anëtarët e familjes, kurse gruan nuk e obligon që financiarisht të harxhojë për familjen. Nëse bëjmë një matematikë të thjeshtë, do të del se gruaja me rastin e marrjes së gjysmës së asaj që merr burri, gjendja e saj financiare është më e mirë se ajo e burrit. Burri është i obliguar për mirëmbajtjen e gruas, fëmijëve të vet, gjithashtu edhe të prindërve, nëse nuk mund të mbahen vet dhe motrat nëse nuk kanë mbikë-

qyrje. Kjo len të nënkuptojë se ajo çfarë merr burri nga trashëgimia është në harxhim të vazhdueshëm nga obligimet e shumta. Kurse gruaja, atë e mban vetëm për vetveten, ajo është e lirë në trashëgiminë e saj ta kultivojë me pavarësi të plotë nga burri, pra ajo nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj familjes, kurse burri është i obliguar ndaj saj edhe nëse ajo është e pasur, kjo njëkohësisht d.m.th. se pasuria e saj është në rritje të vazhdueshme. Kjo len të nënkuptojë se gruas absolutisht nuk i bëhet e padrejtë, ajo nuk nënçmohet, madje këtu peshorja anon në interes të saj.

3. Një çështje e cila duhet theksuar në lidhje me trashëgiminë ka të bëjë me atë se kjo hise e parapare për gruan - 1/2 e asaj të burrit, nuk është vendim i përgjithshëm as rregull konstant në trashëgiminë islame për çdo mashkull ose femër. Kur'ani nuk thotë se Allahu u urdhëron që në trashëgimi, për ata që trashëgojnë, për burrat hise sa për dy gra, por thotë:

“Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimit) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra.” (en Nisæ 11)

Këtu pra kemi dallim të qartë mes shprehjeve.

Hulumtimet e ajeteve, që flasin mbi çështje të trashëgimisë na shfaqin një të vërtetë krejt ndry-

she nga ajo që është ngulitur në mendjet rreth trashëgimisë së gruas dhe asaj që i ndërlidhin gabimisht për nënçmim të aftësive të saj. Në bazë të kësaj shihet se kemi vetëm katër raste kur gruaja trashëgon sasi sa gjysma e asaj të burrit, kurse kemi më shumë se tridhjetë raste ku gruaja trashëgon njësoj si burri, ose më shumë se ai, apo trashëgon ajo e nuk trashëgon burri.⁴⁷

Nga shumë shembuj në lidhje me këtë po sjellim shembullin kur në rast të vdekjes së burrit, ose gruas dhe ai ose ajo nuk kanë prindë ose fëmijë, por kanë vetëm vëlla ose motër nga nëna, me këtë rast, motra dhe vëllai janë të barabartë në trashëgimi.⁴⁸ Kështu edhe në rastin kur burrit i vdes gruaja e cila pas vete ka lënë një vajzë - qoftë ajo vajzë edhe e tija, ose nga martesë e mëparshme, vajza trashëgon dyfish më shumë se burri. Kështu ka edhe raste të tjera. Këto sasi janë të caktuara në Kur'anin Fisnik dhe ato zgjidhin të gjitha format e konflikteve mes anëtarëve të familjes. Qendra egjiptiane për fetva dëshmon se shumë të krishterë në Egjipt kërkojnë zgjidhje sipas sistemit të trashëgimisë islame, kjo si rezultat i zgjidhjes së konflikteve dhe shuarjes së dallimeve mes atyre që u takon nga trashëgimia.



⁴⁷ Shih: "Hakaik el Islam fi muvaxhehet shubuhât el mush-ekikîn", *el Mexhlis el Alali Shuun el Islamije* Kajro, 2002, f.556-559.

⁴⁸ Sabik, Sejid: "Fikhus Sune", Vëll.III, Bejrut, 1971, f.615.

(IV) PËRSE GRATË DISKREDITOHEN NË ÇËSHTJEN E DËSHMISË?

1. Pohuesit e kësaj akuze konsiderojnë se në çështjen e dëshmisë bëhet nënvlerësimi i gruas, pasi që dëshmia e saj është e vlerësuar si gjysmë dëshmie në raport me atë të burrit. Ky pohim është i gabuar, akuzë që nuk mban.

Burimi i kësaj akuze është përzjerja e konceptit të dëshmisë mbi të cilin flet ajeti fisnik:

“O besimtarë, kur merrni hua prej njëritjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë...” (deri te fjalët) **“Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi i juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burrë e dy gra.”** (el Bekare 282)

Dëshmia mbi të cilën mbështet gjykata, është që gjykatësi të arrijë sigurinë e vet nga dëshmia e singertë, pa marrë parasysh gjininë e dëshmitarit dhe numrin e tyre: *“Kadiu, nëse i fle ndërgjegjja, mund të mbështetet në dëshminë e dy burrave ose dy grave ose në dëshmi të një burri dhe të një gruaje, ose një burri dhe dy grave, ose një gruaje dhe dy burrave, vetëm në një burr, vetëm të një gruaje, pra kur gjykatësi gjykon duke u mbështetur në bazë të argum-*

entevë të ofruara, nuk ka ndikim ajo se dëshmia vjen nga një mashkull apo femër."

2. Kurse ajeti fisnik, të cilin e sollëm më lart (el *Bekare* 282), flet për një çështje tjetër, jo për dëshmi para gjykatës, por për prani kur dikush i jep huazim dikujt me qëllim që ajo të mbahet mend, e jo si diçka që obligon gjykatësin në raste të mosmarrëveshjeve. Këtë perceptim kanë vërtetuar një numër nga dijetarët e pranueshëm, nga muxhtehidët në të kaluarën dhe të kohës bashkëkohore, sikur Ibën Tejmije, Ibën Kajim, Muhamed Abduhu, Sheltuti etj.

Ibën Kajimi thotë se në Kur'an Fisnik nuk gjejmë të mos gjykohet nëse kemi dy dëshmitarë, një dëshmitarë dhe dy gra. Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar njerëzit për të mbrojtur të drejtat e tyre me këtë sasi (në atë që mëson ajeti fisnik), por me të nuk ka urdhëruar gjykatësit për të gjykuar.

3. Ajeti në fjalë (pra el *Bekare* 282) jep shpjegimin përse është kërkuar dëshmia e dy grave dhe jo vetëm e një gruaje kur thotë:

"Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi i juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burrë e dy gra, nga dëshmitarët që i pëlqeni. (Dy gra në vend të një burri) Për atë se

nëse njëra prej tyre gabon, t'ia përkujtojë tjetra." (el Bekare 282)

Pra për ta përkujtuar njëra tjetrën në rast të harresës.

Ajo çfarë nuk bën të nënkuptohet nga kjo është se harresa nuk është veti e grave apo çështje e prerë në të gjitha llojet e dëshmive që i ushtron gruaja, por është një çështje që ka të bëjë me përvojën, pra është nga çështjet të cilat zhvillohen dhe ndryshohen. Nga këtu, kur kemi përvojën e gruas në temën e dëshmisë, dëshmia e saj në këtë rast është e barabartë me atë të burrit. Nga këtu gjejmë se Muhamed Abduhu shkakun në dëshminë e dy grave në lidhje me borxhin e thotë, ngase, puna me financa, tregti e të ngjashme, nuk ka qenë e natyrës me të cilën janë marrë gratë. Kështu kujtesa në çështje të atilla është e dobët. Kjo pra ka qenë një realitet historik që pranon zhvillim dhe ndryshim, dhe nuk ka të bëjë me natyrën e grave.

Gruaja sot konkuron burrin në profesionet e informatikës, ekonomisë, administratës, kështu kemi nga gratë që merren me biznese dhe u konkurojnë meshkujve, çështje që lidhur me borxhin bëjnë të mos jetë e kërkuar dëshmia e dy grave në vend se të jetë një.⁴⁹



⁴⁹ Shih: "Hak alk el Islam fi muvaxhehet shubuhat el mushekik-in", f.560-574.

Nga kjo na qartësohet se kjo akuzë në esencë është e pa vend dhe se të kuptuarit e ngushtë të teksteve kur'anore shpijnë në gabime mbi gabime, së këndejmi, dëmtojnë Islamin, mësimet dhe normat e tij të larta.

(V) CILI ËSHTË QËNDRIMI ISLAM MBI POZITA TË LARTA UDHËHEQËSETË GRUAS?

1. Islami nuk ndalon gruan që ajo të ketë pozitë të lartë në shtet. Ajo duhet të jetë në ato pozita që përputhen me natyrën, përvojën, aftësinë dhe kualifikimin e saj. Kurse hadithi i Pejgamberit a.s. në të cilin janë mbështetur dijetarët në moslejin e gruas në detyra publike, është:

“Nuk do të kenë sukses një popull, çështja e të cilit drejtohet nga një grua.”⁵⁰

Mirëpo ky hadith ka rastin e vet të veçantë, u tha me rastin kur Muhamedi a.s. u njoftua se Persianët ia kishin dhënë pushtetin vajzës së Kisras. Kështu përfundimi i nxjerrë i dijetarëve është se gruaja nuk udhëheq pozita publike në kuptim të kryetarit të shtetit ose kalifatit, mirëpo nuk guxon të mungojë nga mendjet tona fakti se Kur'ani i Madhërishëm përmendë mbretëreshën e Sebeit, në suren *en Neml* duke e lavdëruar atë



⁵⁰ Transmetoi Buhariu në *el Megazi*, *el Fiten*.

për urtësinë e saj në zgjidhjen e çështjeve. Kjo ka një argument të rëndësishëm se në ç'masë Kur'an-i Famëlartë e vlerëson gruan dhe aftësitë e saja për të vepruar mirë e arsyeshëm, kur ajo është në kreun e shtetit.

2. Shumë dijetarë islam në periudha të ndryshme lidhur me gruan kanë mendime të avancuara. Imam Ibën Hazëm thotë se lejohet gruaja të udhëheq pushtetin. Ky mendim gjithashtu është edhe i Imam Ebu Hanifes, themeluesit të shkollës së njohur juridike. Kurse Imam Ibën Xherir et Taberi lejoi që gruaja të udhëheq në çdo gjë. Transmetohet se Kalifi Omer Ibën Hatabi kishte emëruar Shifa Bint Abdullah el Mahzumije për çështjet e vlerave të rëndësishme në tregun e Medinës, që ishte një detyrë fetaro – civile, që kërkonte përvojë dhe mprehtësi.⁵¹

3. Pasi që Islami nuk e ndalon gruan nga e drejta e saj për pozitë të lartë në shtet, derisa ajo është kompetente për të, nuk duhet lënë pas dore përgjegjësinë e saj themelore ndaj familjes së saj, fëmijëve, bashkëshortit. Familja është bërthama e parë në ngritjen e shoqërisë, e nëse ajo shkatërrohet, kjo paraqet paralajmërim për shkatërrimin e



⁵¹ E Kardavi, Jusuf: **"Fetavi Muasire"**, *Dar Afak El Gad*, 1978, f.63; E Gazali, Muhamed: **"Miet sual fi el Islam"**, Vëll. II, f.260,262 dhe 276.

shoqërisë. Pra ajo që kërkohet është harmonia mes punës së gruas jashtë shtëpisë dhe përgjegjësia e saj në shtëpi në interes të mbarë shoqërisë.

(VI) CILI ËSHTË QËNDRIMI I ISLAMIT MBI HIXHABIN E GRUAS DHE TË DREJTAT E SAJA PËR SHKOLLIM DHE PUNË?

1. Hixhabin - mbulesën me të cilën obligohet gruaja, nuk kërkon nga ajo pos modesti në veshje dhe në dukjen e saj për të mos u ballafaquar me shqetësimet nga ana e burrave. Mbulesa pra është mburojë për gruan e jo diçka që e lidhë dhe e paralizon nga lëvizja. Mbulesa nuk nënkupton fshehjen e fytyrës ose veshjen e dorëzave, kjo nuk ka të bëjë me parimet islame, por me adetet dhe traditat e disa shoqërive për të cilat Islami nuk është përgjegjës.

Mbulesa, ashtu siç është nga vlerat në Islam, ajo gjithashtu vazhdon të jetë edhe në fenë krishtere, argument në këtë kemi veshjen e murgeshave të krishtera të cilat mbulojnë tërë trupin, flokët dhe nuk shfaqin pos fytyrës dhe duarve. Kurse Inxhili kërkon që gruaja t'i mbulojë flokët e saja gjatë lutjes.⁵² Gjatë rasteve kur Papa i Vatikanit pranon ndonjë grua, qoftë ajo e zonja e ndonjë kryetari të



⁵² Lexo: Is-hah 11.

shtetit perëndimor, ose ndonjë nga yjet e njohura, hasim se si ato mbulojnë flokët e veta.

2. Islami nuk ndalon gruan nga shkollimi, por e vërteta është e kundërta. Islami ka bërë nxënien e diturisë obligim të domosdoshëm si për burrin ashtu edhe për gruan, ashtu siç vjen në hadithin e Muhamedit a.s.:

“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman.”⁵³

Historia Islame shënon shumë emra të grave të cilat u dalluan në shkencat fetare, në artin e poezisë dhe letërsisë.

Kur i Dërguari a.s. ishte martuar me Hafsën, ajo kishte filluar me mësimin e bazave të leximit dhe shkrimit, ai ia ka besuar El Shefa El Adavijes obligimin që ta mësojë bashkëshorten e tij që ta përmirësojë shkrimin dhe leximin e saj.

Ajsha, e bija e Ebu Berkit dhe bashkëshortja e të Dërguarit a.s. ka qenë më e dijshmja në çështje të fesë, dhe më e dijshme se shumë nga sahabët e Muhamedit a.s. saqë ai vet kishte porositur që të mësohet prej saj në çështje të fesë.

3. Islami gjithashtu nuk e ndalon gruan nga puna, është nga të drejtat e saja që ajo të punojë përderisa ka nevojë për punë, kurse ajo duhet të zgjedh punën e përshtatshme me mundësitë e



⁵³ Transmetoi Ibën Maxhe.

saja dhe kualifikimin e saj. Nuk ka tekste fetare që ndalojnë gruan nga e drejta e saj për shkollim dhe punë. Gruaja në kohën e Muhamedit a.s. bënte shumë punë dhe profesione të ndryshme, si në të ndihmuarit e ushtrive, shërimin e të plagosurve dhe punë të tjera që atë kohë paraqitej nevoja për to.

4. Duhet të bëhet dallim mes parimeve të qarta Islame në mbrojtjen, ruajtjen e gruas nga disa tradita të këqija të cilat frenojnë progresin e gruas dhe qëndrojnë si mur mes saj dhe të drejtave të saja për shkollim dhe punësim në disa shoqëri islame, çështje të cilat nuk kanë asgjë me Islamin. Në të vërtetë, Islami i cili e nderon gruan është i interesuar që ajo ta kultivojë personalitetin e saj, ta bëjë atë më të aftë për edukimin e fëmijëve të saj dhe për të kontribuar në ngritjen e një gjenerate të fuqishme, e cila do të punojë në zhvillimin e shoqërisë, progresit dhe lulëzimit të tij.

(VII) A ËSHTË MBULESA E PAPËRSHTATSHME PËR JETËN MODERNE?

1. Çdo komb ka specifikat e veta të veçanta, traditat që shihen në ushqim, pije, veshje, banim etj. e të gjitha këto prezantojnë kulturën, civilizimin edhe fenë e një kombi. Allahu xh.sh. krijoi

njerëzit të ndryshëm nga njerëzit në shumë qështje, e ky dallim do të jetë deri në fund të kësaj bote. Ajo çfarë është e mirë për një popull, mund që të mos jetë e mirë për një tjetër. Shembull, gruaja indiane ka veshje të veçantë dhe ajo nuk kritikohet për veshjen e vet, as në vendet perëndimore, përkundër asaj se veshja mund të jetë jopraktike, megjithëkëtë, ajo veshje mbahet nga gruaja e rëndomtë në Indi ashtu siç mbahej edhe nga kryeministria e Indisë Indira Gandhi, pa thënë kush se veshja në fjalë e pengonte në punë dhe produktivitet.

2. Shumica e grave evropiane deri në fillim të shekullit XX, mbulonin flokët e tyre dhe vishnin rrobe të gjata dhe askush nuk i kritikonte. Mirëpo me fillimin e ndërhyrjes në veshje, ato u zhvilluan saqë arritën në atë që jemi tani e që nuk merret parasysh asnjë normë apo kriter. Kjo ndoshta do të ndryshojë pas një kohe, në varësi nga ajo se si vendosin shtëpitë e modës.

3. Islami nga gruaja myslimane nuk kërkon ndonjë stil të posaçëm të veshjes. Islami kërkon që veshja e saj të jetë e rehatshme, komode, pra që ta mbrojë nga provokimet dhe, nuk është e vërtetë se veshja islame e pengon gruan nga puna dhe produktiviteti. Në të gjitha institucion-

et shtetërore gjejmë shumë gra të moshave të ndryshme të cilat ushtrojnë punën e vet krejt rëndomtë, sikurse koleget e tyre që janë pa mbulesë. Andaj kjo akuzë qëndron mbi baza jo logjike dhe askush nuk ka bërë ndonjë studim shkencor që konfirmon atë pohim.

Tërë problemi në lidhje me këtë çështje ka të bëjë me atë se perëndimorët dëshirojnë që vlerat, traditat, adetet e tyre të jen të pranishme në të gjitha vendet, e kjo është kundër natyrës së gjërave, ngase çdo popull ka specifikat e veta dhe ka identitetin e vet. Nga të drejtat e gruas myslimane është që ajo ta ketë personalitetin e saj dhe vetitë e saja specifike në veshje, sjellje, ashtu sikur gruaja indiane dhe evropiane që e kanë këtë të drejtë.

4. Ka nga gratë myslimane sot që mbajnë pozitat më të larta dhe që punën e tyre e kryejnë me sukses, edhe pse janë të mbuluara. Benazir Buto e cila ishte në kreun e një ndër shtetet më të mëdha myslimane, mbante një veshje të afërtë me atë islamen, por punën e vet e kryente në mënyrë të suksesshme, nuk ishte e penguar nga veshja për të realizuar detyrat e saja. Ngjashëm ishte puna edhe me veshjen e kryeministres së Bangladeshit.

(VIII) PSE ISLAMI LEJON POLIGAMINË?

1. Islami nuk është feja e parë e cila lejoi poligaminë, nuk e shpiku këtë sistem, por ishte feja e parë e cila rregulloi çështjet e martesës dhe kufizoi poligaminë, duke e kushtëzuar atë me kushte të rrepta. Kur u shfaq Islami, poligamia ishte e lejuar e pakufizuar, jo vetëm tek arabët por te të gjithë popujt në një formë ose tjetër. Islami me legjislacionin e vet të ri ndjek metodën graduale në legjislaturë kundër adeteve të këqija që dominonin në shoqëri. Dëbimi i përnjëhershëm i adeteve dhe traditave të cilat kanë rrënjë gjatë periudhave të ndryshme, është nga punët e vështira, andaj, gjejmë këtë metodë edhe në lidhje me poligaminë.

2. Islami kufizoi poligaminë në katër gra:

“Martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tre dhe me katër.” (en Nisâ3)

Por megjithëkëtë, kufizimi nuk është i pakushtëzuar, ai kushtëzohet me një kusht bazë që është i domosdoshëm; drejtësia mes grave. Kjo d.m.th. të mos bëhet dallim mes grave në asnjë çështje. Muhamedi a.s. tërhoqi vërejtjen nga mosrespektimi i këtij kushti dhe tha:

“Kush ka dy gra dhe anon nga njëra në dëm të tjetrës, ditën e kiametit do të vjen si kur gjysma e tij i ka rënë.”⁵⁴

3. Kur'ani Famëllartë tërheq vërejtjen se drejtësia mes grave është nga çështjet që rëndë mund të arrijet dhe se njeriu sa e sa të angazhohet nuk mund të arrijë të vendos plotësisht barazinë mes tyre:

“Kurrësi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni.” (en Nisaaë 129)

E nëse puna na qenka kështu, se rëndë mund të mbahet drejtësia mes grave, atëherë duhet të mjaftohet me një grua. Kjo me qartësi theksohet në ajetin fisnik:

“...e nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj grave), atëherë vetëm me një.” (en Nisaaë 3)

E ky ligj është i ardhur që para katërmëdhjetë shekujsh.

4. Nga faktet e lartpërmendura bëhet e qartë se Islami nuk ka detyruar martesën me katër gra e as që ka shpikur poligaminë, por poligamia ishte një realitet që Islami deshi ta shërojë përmes një urtësie dhe pa shkaktuar reaksione në shoqëri.



⁵⁴ Transmetoi Ibën Maxhe, en Nikah, Vëll.I, f.633

Kjo na shpjegon neve se në Islam monogamia është rregull, kurse poligamia është përjashtim. E në rast se Islami e ka lejuar këtë përjashtim vetëm në disa raste të caktuara dhe të logjikshme për shërimin e disa gjendjeve të veçanta, si psh. gjatë luftërave kur shumë burra vriten në mejdanet e luftës, është pra një gjendje përjashtimi që përmes poligamisë arrihet mbrojtja e grave nga devijimet, ose rastet kur gruaja sëmuret me ndonjë sëmundje nga e cila asaj i pamundësohet që t'i kryej obligimet e saja bashkëshortore, ose ajo është e paaftë për lindje, kështu për mbrojtjen e bashkëshortit nga devijimi, lejohet martesë me tjetër, e cila duhet të jetë e barabartë me atë të parën në të gjitha të drejtat. E kur Islami ngel me këtë përjashtim, ai në të njëjtën kohë eliminon rrezikun e poligamisë së jashtëligjshme, poligami kjo, e cila nuk kundërshtohet nga bota perëndimore.

(IX) A PARAQET NDALIMI I MARTESES SË MYSLIMANES ME JOMYSLIMAN TENDENCË RACISTE?

1. Është e vërtetë se Islami lejon martesën e myslimanit me jomyslimane (të krishtere ose hebraike), kurse nuk lejon martesën e myslimanes me jomysliman. Në shikim të parë kjo mund të duket si diçka që ka të bëjë me mosbarazinë,

mirëpo nëse njohim shkakun e vërtetë, hidhet poshtë mundësia e mosbarazisë. Në lidhje me këtë Islami bën të njohur urtësinë e kësaj norme e cila sikur edhe normat e tjera ndërtohet mbi urtësi të caktuara dhe interes të vërtetë të të dy palëve.

2. Martesa në Islam qëndron mbi dashurinë, mëshirën dhe prehjen shpirtërore. Islami kujdeset që familja të ngrihet mbi baza të shëndosha që garantojnë vazhdimin e bashkëshortësisë. Islami është fe e cila respekton fetë e mëparshme qiellore dhe besimin në të gjithë të dërguarit e mëparshëm e bëri pjesë të pandashme të besimit Islam. Kështu, nëse myslimani martohet me të krishtere ose hebraike, ai është i urdhëruar për respektim të besimit të saj dhe, sipas Islamit, nuk i lejohet të pengojë gruan e vet të praktikojë fenë dhe shkuarjen e saj në kishë ose faltore. Kështu pra Islami kujdeset për të siguruar elementin e respektit nga ana e bashkëshortit për besimin dhe lutjet e bashkëshortes së tij; në këtë pra kemi garanci dhe mbrojtje të familjes nga shkatërrimi.

3. Kurse në rast se martohet jomyslimani me myslimane, elementi i respektit të besimit të bashkëshortes është i humbur. Myslimani beson në fetë e mëparshme, në të dërguarit e mëparshëm, i respekton ata, mirëpo jomyslimani nuk

beson në të dërguarin e islamit dhe nuk e pranon atë, madje e konsiderojnë për të dërguar të rrejshëm, dhe si zakonisht beson gjithçka që përhapet kundër islamit dhe Muhamedit a.s. nga shpifjet dhe gënjeshttrat e shumta. Edhe sikur bashkëshorti i myslimanës nuk do të shprehet para saj në lidhje me këtë, ajo do të vazhdojë së jetuari nën një ndjenjë të mosrespektimit të bashkëshortit ndaj besimit të saj. Çështja ka të bëjë në parim me thelbin e respektit të ndërsjellë mes çiftit bashkëshortorë, që është baza e vazhdimësisë së jetës bashkëshortore.

4. Islami ishte i logjikshëm me vetveten kur ndaloi martesën e myslimanit me jomyslimane të cilat për fe kanë diçka tjetër nga ajo krishtere dhe hebraike, kurse kjo për shkaqe të njëjta për të cilat ndaloi myslimanës martesën me jomysliman.

Myslimani pra pranon për besime vetëm ato që janë qiellore, çdo gjë tjetër konsideron për besime njerëzore. Elementi i respektit dhe nderimit të besimit të bashkëshortes në këtë rast është i humbur, e kjo ndikon negativisht në lidhjet bashkëshortore dhe nuk mund të arrihet dashuria dhe mëshira e kërkuar në lidhjen bashkëshortore.

KREU I GJASHTË

LIRITËNË FE, BASHKIMI ISLAM DHE PRAPAMBETURIA E DISA PREJ KOMBEVE ISLAME

(I) A ËSHTË E VËRTETË SE ISLAMI
KUNDËRSHTON LIRINË E BESIMIT?

1. Islami me një qartësi të plotë garanton lirinë e besimit:

"Nuk ka shtrëngim në Fe." (El Bekare:256)

Në pajtueshmëri me këtë, askënd nuk duhet detyruar që të heqë dorë prej fesë së vetë. Liria e njeriut në zgjedhjen e besimit të tij është esenca e besimit. Këtë të vërtetë Kur'ani Fisnik e përforcon në një mënyrë sa nuk ka nevojë për shpjegime:

"E ti thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj, kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë." (el Kehf:29)

2. Vendimi mbi lirinë në fe, nënkupton njohjen e pluralizmit fetar, gjë të cilën gjejmë se Pejgamb-

eri a.s. në Kushtetutën e parë të Medinës pranoi hebrenjtë dhe proklamoi se ata bashkërisht me myslimanët formojnë një umet - bashkësi.

Nga ky kënd i lirisë fetare që ngërthen Islami, Kalifi Omer Ibën Hatabi r.a. i siguroi të krishterët e Kudsit – Jerusalemit për mbrojtjen e jetës, kishës dhe kryqit, duke i bindur ata se asnjëri prej tyre nuk do të lëndohet për shkak të fesë së tij.

3. Islami gjithashtu mbron edhe lirinë e dialogut objektiv fetar, larg keqpërdorimeve ose përqeshjes së tjerëve. Në lidhje me këtë në Kur'an thuhet:

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe diskuto me ata me atë që është më e mira...” (*en Nahd:125*)

Në bazë të këtyre parimeve duhet zhvilluar dialogu në mes myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Kur'ani Famëlartë i fton për dialog ithtarët e librit përmes këtij ajeti:

“Thuaju (o i dërguar): O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin Zot pos Allahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë.” (*Ali Imran:64*)

Kjo nënkupton, në rast se dialogu nuk sjellë rezultatin, secili i mbetet besnik fesë së tij, asaj që është i bindur. Kjo është shprehur gjithashtu në ajetin e fundit të sures *el Kafirunë* fjalë me të cilat Muhamedi a.s. u është drejtuar idhujtarëve mekas:

“Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!” (*el Kafirunë*6)

4. Bindja është esenca e besimit. Besimi i vërtetë është ai që ngrihet mbi bindjen e pakontestueshme dhe, jo thjesht mbi imitim ose detyrim. Secili individ është i lirë që të besojë çfarë të dojë dhe në vetvete të ndërtojë ato mendime që i dëshiron, qofshin ato mendime edhe ateiste. Pra në këtë askush nuk mund ta pengojë, përderisa ato mendime i ruan për vetvete dhe me të njëjtat nuk i dëmton të tjerët. Mirëpo, nëse tenton që ato mendime që janë në kundërshtim me besimet e njerëzve dhe lëndon vlerat e atyre që me përkushtim besojnë, ai me këtë prishë rendin publik të shtetit, pra duke iniciuar trazirë dhe dyshime te njerëzit. Kurse çdo njeri i cili shkel rendin publik të shtetit, në çdo popull nga popujt, ballafaqohet me sanksione, që mund të arrijë deri në akuzë për tradhti të madhe për të cilën shumica e shteteve gjykojnë me vdekje.

Ekzekutimi i *murtedit* – renegatit, femohuesit, sipas sheriatit islam nuk bëhet vetëm për shkak

se ai mohoi fenë, por edhe për inicim të trazirës, thashethemeve kundër rendit publik në shtetin islam. E në rast se mohimi i tij ngelet vetëm tek ai, pra pa e përhapur mes njerëzve dhe pa shkak-tuar dyshime në masë, askush nuk ka mundësi që atij t'i shkaktojë ndonjë të keqe. Allahu xh.sh. është i vetmi i cili din atë çfarë mbahet e fshehur.

Disa dijetarë mysliman janë të mendimit se sanksioni për murtedët nuk ka të bëjë me atë të dyn-jasë por të ahiretit dhe se vrasja e tyre, në bazë të disa haditheve peygamberike nuk ishte për shkak mohimit të fesë, por për shkak luftës që bënin kundër Islamit dhe myslimanëve.⁵⁵ Ky vështrim është i logjikshëm dhe meriton konsideratë.

(II) A ËSHTË QËNDRIMI I MYSLIMANËVE NDAJ SELMAN RUZHDIUT KUNDËR LIRISË SË TË SHPREHURIT?

1. Liria e të menduarit dhe shprehjes është njëra prej të drejtave të garantuara dhe të pakufi-shme në Islam. E tërë gjithësia, me qiellin, tokën dhe çfarë ka mes tyre është sferë e saja. Në Kur'anin Fisnik thuhet:



⁵⁵ E Saidi, Abdul Miteal: "el Hurije ed Dinije fil Islam", *Dar el Fikr el Arabi*, botimi i dytë, f.3, 72, 73, 88.

“Dhe për ju nënshtroi gjithë çka në qiej dhe në tokë, të gjitha janë prej Tij. Vërtetë në këto ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (el Xhathije 13)

Kur’ani Fisnik qorton ata të cilët nuk i përdorin aftësitë e tyre mentale dhe i vendosë ata në një nivel edhe më të ulët se niveli i kafshëve. Kur’ani Fisnik përmban dhjetëra ajete me anë të të cilave thërret në dituri, lartëson vlerën e mendjes dhe obligon njeriun për ndërtim në tokë.⁵⁶ Njerëzit sipas fesë janë të obliguar që të mendojnë, të meditojnë dhe të shprehën mbi gjithësinë e cila i rrethon. Islami e inkurajon lirinë e mendimit dhe të shprehurit e saj përderisa ajo është në dobi të njerëzimit.

2. Çdo komb i ka vlerat e saja fetare të cilat i respekton dhe që janë pjesë përbërëse e besimit që i janë të dorëzuar, që janë vlera që i mbrojnë dhe me ndikim të madh në formimin e identitetit dhe kulturës nacionale. Andaj, atakimi i vlerave të shenjta, përmes fjalës, veprës ose përqeshjes, d.m.th. atakim kundër vet umetit, atakim kundër rendit publik në të. Nga të drejtat e çdo populli është mbrojtja e vlerave të tij të shenjta, të mbrojë



⁵⁶ Shih librin: **“Et Tefkir feri da Islamiye”** të prof. Abas Mahmud Akad.

rendin e tij nga çdo formë nënçmimi. Kjo na sqaron neve sjelljen e myslimanëve ndaj Selman Ruzhdiut për të cilin kanë ndjerë se ai atakoi mbi vlerat e shenjta të tyre me të cilat ata janë krenarë, ofenduan Pejgamberin e tyre. Qëndrimi i tyre pra ishte i arsyeshëm.

3. Është e qartë se çështja lidhur me Selman Ruzhdiun nuk ka të bëjë me lirinë e të shprehurit, por ajo sillet rreth popullaritetit dhe ofendimit – nëse duam t'i emërtojmë gjërat me emrat e vërtetë, me diçka të këtillë nuk mund të pajtohet asnjë popull. Kurse ne myslimanët do të ishim hidhëruar në të njëjtën masë sikur t'iu ishin drejtuar ofendimet edhe Musait a.s. dhe Isait a.s. ose ndonjë pejgamberi tjetër të Allahut xh.sh. mirëpo, kjo nuk d.m.th. se pajtohemi në vrasjen e Selman Ruzhdiut ose gjykimin të tij, ngase ai nuk jeton në vend islam ku mund të gjykohej.

4. Masmediat përëndimore kontribuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë në ngatërrimin e lirisë së të shprehurit dhe lirisë së popullaritetit dhe ofendimit, duhet të bëhet dallim mes tyre. Fakti që Selman Ruzhdiu zgjodhi vlerat e shenjta islame për të arritur popullaritet paraqet mungesë në ide dhe inspirim në njërën anë, dhe orvatje e qëllim të për t'u tallur me vlerat islame

në anën tjetër. Një shkrimtar i mirëfilltë para vetes ka horizont të gjerë për të krijuar, kurse një i harxhuar, zgjedh një temë nga temat thumbuese, në veçanti kur ato kanë të bëjnë me besimet e njerëzve përmes të cilave synon popullaritetin, në çka Selman Ruzhdiu ia arriti.

Për myslimanët do të kishte qenë më mirë që thjeshtë ta injoronin atë plotësisht. Ai nuk është personi i parë që atakoi vlerat islame dhe nuk do të jetë i fundit, librat e tij e as ato të të tjerëve nuk do të kenë asnjë ndikim në këtë fe, e cila qëndron gjatë katërmëdhjetë shekuj.

(III) A ËSHTË E VËRTETË SE SANKSIONET NË ISLAM JANË BRUTALE DHETË EGRA?

1. Islami nuk është fe e cila e dëshiron brutalitetin dhe dhunën, e kundërta e kësaj është e vërteta. Islami thërret në mëshirë, butësi dhe tolerancë. Megjithëkëtë, njëkohësisht insiston në vendosjen e ligjit dhe rendit në shoqëri për të garantuar lirinë dhe të drejtat e anëtarëve të saj. Synon ta mbrojë jetën, besimin, mendjen, pronat dhe nderin.

Kur Islami cakton një sanksion për ndonjë gabim, shqyrtohen dy faktorë esencjal:

(a) Njeriu nuk është i pagabueshëm, madje vazhdimisht i është eksponuar gabimit. Nga këtu, Islami hapi portën e pendimit para mëkatarëve të cilët pendohen për shkak të gabimeve, të cilat i kanë bërë dhe që kanë dëshirë të pastrohen.

(b) Secili anëtarë i shoqërisë është i interesuar që të jetojë një jetë të sigurt dhe të ndjejë se ai, familja e tij dhe pasuria e tij nuk i janë eksponuar asnjëfarë lloj rreziku. Andaj, devijimet e disave nuk bën të shndërrohen në dukuri rrënuese të sigurisë së shoqërisë.

2. Me që Islami ka vendosur ligje për sanksione, ai thërret në ikje nga dyshimet, ndërprerje të sanksionit në raste kur gjykatësi vëren se i akuzuari sinqerisht është penduar. Pejgamberi a.s. thotë:

“Mundohuni aq sa keni mundësi t’i shmangeni sanksioneve, nëse gjeni rrugëdalje, lirohuni nga ai. Vërtetë të gabuarit në falje është më me shumë mirësi se sa të gabohet në sanksionim.”⁵⁷

Ky hadith argumenton tolerancën e lartë.

3. Dënimi për *zinanë* është nga çështjet e rënda për t’u realizuar, marrë parasysh se Islami ka



⁵⁷ Transmetoi Tirmidhiu, El Hakimi në Musnedin e tij etj.(Shif: “Fejd el Kadir” El Menavi, Vëll.I, f.226. Bejrut 1972)

parashtruar kushte për verifikim të mëkatit, duhet të dëshmohet nga ana e katër personave të cilët duhet që të betohen se e kanë parë aktin qartë, pa qenë në dyshim. Çështje kjo e cila thuaja se është nga të pamundurat. Nga këtu, dy rastet në historinë islame kur ky dënim u imponua që të realizohet, ishin si rezultat i pranimi të fajit nga ana e vet personave dhe jo me dëshmi të dëshmitarëve. Muhamedi a.s. disa herë është orvatur që ata të kthejnë nga deklaratat e tyre, mirëpo ata me këmbëngulje qëndruan pas pranimi të fajit, kështu që i Dërguari a.s. u detyrua të urdhëroj zbatimin e dënimit. Është krejt e qartë se kjo ndodhi me keqardhje të tij.

4. Islami nuk i pret dorën atij që vjedh për t'u ushqyer vetveten ose fëmijët e tij, por dënon vjedhësin mburravec i cili vjedhë atë që të tjerët e fitojnë me punë dhe ndershmëri, pra dënon atë që në shoqëri përhapë të keqen. Ky mëkatar meriton të dënohet dhe nuk meriton kurrfarë mëshire nga dikush, meqë atij vet nuk i ka ardhur keq për njerëzit të cilëve u ka vjedhur. Ndoshta viktimat e tij ka pasur nevojë të madhe për pasurinë që i është vjedhur, kështu, është obligim i shoqërisë të mbrojë të drejtat e viktimës. Falë aplikimit të këtij ligji në shoqërinë islame – kur ishte në aplikim, rastet e vjedhjes në shoqëri ishin

të rralla dhe rezultoi që tregtarët ta linin mallin e tyre pa roje, pa i mbyllur dyert. Nga ana tjetër, krejt e kundërta është në shoqëritë e tjera, të cilat për vjedhjen parashohin masa të buta, vjedhja është më e përhapur, saqë ajo në disa shoqëri paraqet fenomen të rrezikshëm.⁵⁸

5. Dënimi për vjedhje bëhet me qëllim të sigurimit të drejtësisë sociale dhe çrrënjësjes së varfërisë në shoqëri, çështje që bën qytetarin të mos ndjejë arsye që e nxit për vjedhje. Nga këtu Kalifi Omer Ibën Hatab r.a. e ndërpreu aplikimin e dënimit për vjedhje në vitin e skamjes me të cilin u përballen vendet e myslimanëve të asaj kohe. Kurse gjatë periudhës së parë të Omer Ibën Hatabit kur aplikohet dënimi për vjedhje, udhëtari prej Meke në Siri nuk kishte frikë pos nga Allahu xh.sh. ose nga mundësia që bagëtinë e tyre ta sulmojë ujku. Çdo vjedhës paraprakisht ishte i njohur se cili është dënimi, andaj për këtë krim ata mendonin një mijë herë, dhe kështu edhe për të tjera shkelje. Së këndejmi, rrallë ndodheshin dënimet. Andaj, cila është me përparësi?

Mbrojtja e sigurisë në shoqëri, edhe nëse ajo kërkon aplikimin e sanksioneve kundër disa kriminelëve apo mbushja e burgjeve me kriminel dhe krijim të rrëmujës në sigurimin e shoqërisë?



⁵⁸ El Gazali, Muhammad: "**Miet sual fi el Islam**", Vëll. II, f.41.

Kush meriton keqardhje: krimineli apo shoqëria, siguria dhe stabiliteti i saj.

(IV) KU QËNDROJNË SHKAQET E PËRÇARJES SË MYSLIMANËVE PËRKUNDËR THIRRJES ISLAME PËR UNITET?

1. Nuk mohohet nga askush se popujtë myslimanë sot janë të përçarë dhe në grindje mes vete. Ky është një realitet i qartë që nuk kërkon konfirmim. Sidoqoftë, kjo paraqet një periudhë në historinë e myslimanëve dhe në këtë kanë kaluar edhe popujt e tjerë dhe nuk d.m.th. se kështu do të jetë përgjithmonë. Ashtu sikur popujt e Evropës që ia arritën t'i tejkalojnë faktorët përçarës dhe grindës mes tyre, të cilët shihen në dy luftërat botërore në shek. XX. Gjithsesi edhe myslimanët në të ardhmen do t'ia arrijnë t'i tejkalojnë faktorët e përçarjes së tyre dhe të kërkimit të mënyrës së përshtatshme për bashkëpunim frytdhënës në interes të gjithë shoqërisë islame.

Në këtë drejtim janë bërë dhe po bëhen shumë orvatje, edhe pse ato janë të ngadalshme dhe me ndikim të kufizuar, por janë për t'u përsëritur, si p.sh. Organizata e Konferencës Islame që i përfshinë të gjitha shtetet myslimane. Kështu është e mundur që të ngritet veprimtaria në këtë

organizatë, por edhe në organizatat e tjera islame me qëllim të arritjes së një shkalle më të lartë të bashkëpunimit. Umeti në mësimet islame mbi unitetin, bashkëpunimin, solidaritetin, gjen mbështetje madhështore që garanton suksesin e këtyre orvatjeve.

2. Islami në burimet e tij bazë thërret në bashkim, solidaritet dhe tërheq vërejtjen kundër përçarjes, kontestëve dhe grindjeve:

“Dhe mbahuni që të gjithë për litarin (Kur’anin) e Allahut, e mos u përçani!” (*Ali Imran:103*)

“Dhe respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë.” (*d Enfalë46*)

Islami thërret në ngushëllim me dhembjet e të tjerëve, në pjesëmarrje të lehtësimit të dhembjeve të të tjerëve, dhe bënë që umeti të jetë si një trup i vetëm, siç thotë Pejgamberi a.s.:

“Nëse një gjymtyrë dhemb atëherë i tërë trupi është i shqetësuar për shkak të pagjumësisë dhe etheve.”⁵⁹



⁵⁹ Transmetoi Imam Muslimi dhe të tjerë. (Shih: “Fajd el Kadir”, Vëll.V, f.514)

Islami konsideron lidhjen e besimit në nivel të lidhjes vëllazërore:

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër.” (*el Huxhurat:10*)

Kur Pejgamberi a.s. emigroi prej Mekës në Medine, ai i vëllazëroi muhaxhirët me ensarët (mekasit me medinasit). Ata u vëllazëruan dhe ishin të solidarizuar mes vete në të mirë dhe në të keqe. Ajetet kur'anore dhe hadithet e Pejgamberit a.s. në lidhje me këtë janë të shumta.

3. Ekzistojnë shumë faktorë të jashtëm që rezultuan në copëtim dhe përçarje mes myslimanëve në kohën bashkëkohore. Këto shkaqe në masë të madhe rrjedhin prej kohës së epokës kur vendet e botës islame ishin nën dominimin e kolonializmit. Edhe pas përfundimit të kolonializmit, ajo pas vete la probleme të shumta, sikur problemi i kufijve në mes shteteve të ndryshme. Ngase rregulla mbi të cilën ato ndërtonin politikën e tyre ishte “përçaj dhe sundo”, pra është punuar në përçarje të popujve të vendeve të kolonizuara. Ata kanë shfrytëzuar resurset e vendeve, e si pasojë e kësaj ishte varfëria dhe prapambeturia, e cila akoma vazhdon të ndjehet. Shumica e popujve të botës islame vazhdojnë të vuajnë pasojat e kolonializmit.

4. Myslimanët u morën me problemet e shumta që la pas vete kolonializmi dhe neglizhuan principet islame mbi unitetin dhe solidaritetin. Mirëpo popujt myslimanë synojnë bashkimin e përpjekjeve, solidaritetin mes vete, unifikimin e forcave të tyre për të arritur mirëqenien e të gjithë popujve. Secili mysliman, në cilin do vend mysliman qoftë, ndjenë dhembje për myslimanët në vende të tjera të botës dhe solidarizohet me ta, kjo ngase ai është pjesë e umetit islam. Kjo gjithsesi paraqet një bazë të shëndoshë për përpjekjet e kthimit të solidaritetit dhe bashkimit të vendeve islame, në kuptim të bashkimit të përpjekjeve, plotësimit të njëra tjetrës në fushat e kulturës, ekonomisë, politikës, sigurisë, këmbimit të përvojave dhe të gjitha që janë në dobi të myslimanëve, që do të bëjë të aftësohen për një rol pozitiv, për vendosjen e paqes dhe sigurisë.

(V) A ËSHTË ISLAMI FAJTOR PËR PRAPAMBETURINË E MYSLIMANËVE?

1. Faktet historike vërtetojnë se nuk ka mundësi për dyshim, pasi Islami arriti për një kohë të shkurtë të shtrijë një civilizim të madh, nga më të gjatat në histori. Faktet mbi këtë ende mund të shihen, ajo çfarë u trashëguua nga ai në të gjitha lëmitë e shkencës dhe artit.

Bibliotekat në mbarë botën kanë mijëra dorëshkrime arabe - islame të cilat ilustrojnë arritjen e një civilizimi të madh. Gjurmët islame janë të përhapura në tërë botën islame, të cilat dëshmojnë madhështinë e të arriturës së arteve islame.

Civilizimi mysliman në Andalusi dhe ajo qfarë ka ngelur deri më sot e kësaj dite e verifikon këtë në vet Evropën. Në shekullin e dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë në Evropë filloi lëvizja e përkthimit të shkencave të myslimanëve, vepra të cilat ishin themeli mbi të cilin u vendos civilizimi modern Evropian.

2. Kur'ani Famëllartë përmban shumë ajete të cilat e shprehin vlerën e madhe të diturisë dhe dijetarëve, porosinë të vrojtojmë universin dhe të hulumtojmë në të dhe ta ndërtojmë tokën. Pesë ajetet e para të shpallura nga Allahu i Lartmadhërishëm potenconin rëndësinë e diturisë, leximit dhe meditimit.⁶⁰ Kjo çështje ka qenë mirë e kuptuar nga ana e myslimanëve dhe që nga fillimi i kanë kushtuar rëndësi. Kështu dhënia e Islamit për zhvillimin e civilizimit, në kuptimin e saj të gjerë, nuk ka nevojë të argumentohet.



⁶⁰ "Lexo me emrin e Zotit tënd, i dli krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte. (el Alek: 1-5)

3. Kurse sa i përket prapambetures së myslimanëve sot, Islami nuk e bartë fajin. Islami është kundër çdo lloj prapambeturie. Kur myslimanët ngelen pa perceptuar domethëniet esenciale të Islamit, ngelen edhe në fushat e jetës.

Mendimtari algjerian Malik Ibën Nebi në lidhje me këtë shprehet me sinjeritet duke thënë: *“Vërtetë prapambeturia nga ecila vuajnë sot myslimanët, nuk është shkaktuar nga Islami, por është një ndëshkim i merituar nga Islami, si pasojë e largimit të myslimanëve nga ai dhe jo se ishin të lidhur me të sikurse mendojnë disa injorantë”* Pra nuk ekziston lidhshmëri mes Islamit dhe prapambetures së myslimanëve.

4. Islami është dhe do të jetë i hapur ndaj çdo zhvillimi të civilizimit që është në të mirë të njeriut, e kur myslimanët do të gjejnë shkaqet e vërteta të prapambetures së tyre, Islamin nuk do ta gjejnë në mesin e atyre shkaqeve. Do të ketë shkaqe të jashtme të cilat me të madhe kanë të bëjnë me periudhën e kolonializmit të cilat penguan vendet islame drejt lëvizjes pozitive, kjo duke shtuar këtu edhe disa shkaqe të brendshme që shpjen deri në atë sa që myslimanët të harrojnë elementet pozitive dhe vlerat Islame.

5. Nuk duhet përzier mes Islamit dhe realitetit të pozitës së dobët të botës islame sot. Prapamb-

eturia nga e cila vuajnë myslimanët e sotshëm paraqet një periudhë nga periudhat në historinë e tyre, kjo assesi nuk do të thotë se do të ngelin në të përgjithmonë. Gjithashtu, nuk duhet të akuzohet Islami, se gjoja ai qëndron pas kësaj prapambeturie, sikurse nuk bën të akuzohet krishterimi, se gjoja ai është shkaktar i prapambetures së shteteve në Amerikën Latine.

Objektiviteti shkencor në gjykimin e Islamit ndaj civilizimit, duhet të jetë i ngritur në drejtim ku civilizimi duhet që të bazohet mbi mësim të ndershme dhe të jetë i ndërtuar mbi studime objektive, sipas mësimeve islame, e jo në bazë të thashethemeve të dëgjuara, deklaratave të rrejshme dhe paragjytimeve, të cilat nuk kanë lidhje me të vërtetën.

KREU I SHTATË

PYETJE LIDHUR ME DISPOZITA TË CAKTUARA ISLAME

(I) A E PENGON AGJËRIMI PRODUKTIVITETIN?

1. Agjërimi është nga ibadetet me të cilat nuk veçohet Islami. Kur'ani Fisnik na mëson se agjërimi ka qenë i obligueshëm edhe për popujt e mëparshëm:

“O ju që besuat, u është bërë obligim agjër-imi sikurse që u ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush.” (el Bekare 183)

Edhe sot e kësaj dite gjejmë se edhe te fetë tjera është i njohur agjërimi, por është i qartë dallimi mes agjërimit në Islam dhe agjërimit në fetë e tjera. Agjërimi në Islam bëhet në muaj të caktuar sipas kalendarit hixhri – lunar, ai fillon me lindjen e agimit dhe mbaron me perëndimin e diellit, kohë gjatë së cilës abstenohet nga ngrënia, pija dhe nga marrëdhëniet intime. Me këtë kuptojmë se myslimani punon normalisht

gjatë orëve të agjërimit, për dallim nga disa myslimanë që janë të mendimit se agjërimi në këtë mënyrë e zvogëlon efikasitetin e punës së individit dhe të shoqërisë.

2. Agjërimi është larg kësaj akuze, ai në vetë mban efekt të pakontestueshëm me të cilin i funizon njerëzit me energji shpirtërore, ai madje mundëson të punohet edhe më energjikisht se sa kur nuk janë agjërueshëm. Kjo fuqi shpirtërore nuk duhet injoruar, myslimanët në kohën e të Dërguarit a.s. me të luftuan në betejën e Bedrit, luftuan duke qenë agjërueshëm, megjithatë ata triumfuan. Ushtarët egjiptian në vitin 1973 gjithashtu luftuan duke qenë agjërueshëm, megjithatë triumfuan. Pra, agjërimi nuk i zvogëloi aktivitetet e tyre, por në të vërtetë ndodhi e kundërta.

3. Mungesa e aktivitetit dhe zvogëlimi i produktivitetit në disa nga vendet islame gjatë muajit të agjërimit nuk është për shkak të vet agjërimit, por nga disa shkaqe të tjera. Shumica e njerëzve kanë bërë shprehje që tërë natën ta kalojnë të zgjuar, e kjo natyrisht bënë që ditën e nesërme ata të ndihen të rraskapitur dhe nuk kanë forcë që t'i kryejnë obligimet ditore, kurse agjërimitin e kanë vetëm arsyetim. Arsyetim ky që mund të dëgjohet nga fillimi i ditës, e në qoftë se vërtetë

agjërimi është shkaku për lodhjen e tyre, atëherë ata duhej të ndiheshin të lodhur nga fundi i ditës, e jo që nga mëngjesi.

4. Është argumentuar se agjërimi ka dobi të shumta shëndetësore, shpirtërore, sociale dhe edukative. Duhet të jetë një mundësi vjetore e një personi që t'i analizojë veprimet dhe sjelljet e veta, të mendojë rreth sjelljes së tij paraprake, të eliminojë negativitetet dhe shumë sëmundje shoqërore. Pra në këtë drejtim nxit shoqërinë sa më shpejtë, më me shumë përkushtim dhe vetëdijesim më të lartë.

(II) A ËSHTË E VËRTET QË ZEQATI TË PASURVE U JEP PËRPARËSI NDAJ TË VARFËRVE NË ARRITJEN E MIRËSISË SË ALLAHUT XH.SH.?

1. Në historinë e ekonomisë botërore zeqati llogaritet si sistem i parë i organizuar tatimor. Ajo që ekzistonte para kësaj ishin tatimet që caktoheshin sipas tekave të pushtetarëve, pra varësisht se për sa kanë pasur nevojë për të realizuar qëllimet personale. Në fakt, barra e tatimeve të këtilla binte vetëm mbi supet e të varfërve.

Me ardhjen e Islamit dhe obligimit të zeqatit, u organizua tubimi, u caktua sasia duke e bërë që

ajo të bie vetëm mbi supet e të pasurve dhe shtr-esës së mesme, pra duke u liruar nga ky obligim të varfrit.⁶¹

Zeqati nuk është vetëm sistem financiar, por njëkohësisht është ibadet-adhurim, sikurse nam-azi, agjërimi dhe haxhi. Nga këtu, ai paraqet një akt të obligueshëm për atë që ka mundësi ta paguaj, jo nga frika e pushtetit ekzekutiv, por me qëllim të afrimit tek Allahu dhe respektimit të mësimëve të fesë.

2. Në kohën e Muhamedit a.s. të varfrit e kanë ndjerë veten të pamundshëm të japin zeqatin ashtu siç e jepnin të pasurit, kështu ndjenin se të pasurve u jepet privilegj të arrijnë shpërblim nga Allahu që nuk mund ta arrijnë ata. Këtë ndjenjë të tyre ia prezantuan Muhamedit a.s. e ai i porosi ta lartësojnë, falënderojnë dhe madhërojnë Allahun xh.sh. (pra të thonë: *Subhanallah, Elhamdulil-lah, Allahu Ekber*) nga tridhjetë e tre herë pas çdo namazi, duke u bërë me dije se përmes kësaj ata kërkonin gradën e tyre tek Allahu dhe pozita e tyre tek Ai bëhet e njëjtë me atë të të pasurve që japin zeqatin.⁶²



⁶¹ Kutub, Muhamed: "Shubuhat hovlel Islam", Mektebat Vehbe, 1960, f.91.

⁶² "Fetëh el Bari bi sherh sahih el Buhari", Vëll.2. f. 325.

3. Kriteri sipas të cilit Kur'ani Fisnik mbështet në vlerësimin mes njerëzve, përgjithësisht është ai i takvallëkut – devotshmërisë dhe veprave të mira, siç na thotë Kur'ani:

“...s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur.” (*el Huxhuratë* 13)

Takvallëku përfshinë çdo punë të cilën e kryen njeriu, qoftë ajo fetare ose e përditshmërisë, përdërisa puna kryhet për hir të Allahut, në dobi të mirëqenies së njerëzve dhe largimin e së keqes prej tyre.

Arritja deri te rahmeti i Zotit nuk varet vetëm nga dhënia e zeqatit ose kryerjes së riteve të ndryshme fetare, por ajo varet edhe nga vet sjellja e njeriut në përgjithësi, çfarë vepron gjatë jetës së tij, çfarë thotë me gojën e vet dhe për çfarë nijeti – qëllimi, ngase punët vlerësohen sipas qëllimit, ashtu siç thotë Muhamedi a.s.:

“ Vërtetë, çdo punë vlerësohet sipas qëllimit dhe çdo njeri shpërblehet sipas qëllimit të tij.” ⁶³

Kjo d.m.th. se i varfëri i cili nuk mund të jepë zeqatin, dhe shpreson se sikur të posedonte pasuri do të jepte, ai ka shpërblim edhe për këtë,



⁶³ Buhariu, Kapituli *El Vahj* 1, *el Iman* 41, *en Nikah* 5, *et Talak* 11. Tirmidhiu në *Fadai el Xhihad* 16, Nesaiu në *Tahare* 59.

përderisa është i sinqertë. Mund që i pasuri të jepë zeqatin, por qëllimi i tij të jetë vetëm shfaqja para njerëzve dhe arritja e pozitës në mesin e tyre, personi i këtillë fare nuk shpërblehet.

(III) PSE ISLAMI E KA NDALUR NGRËNIEN E MISHIT TË DERRIT?

1. Islami nuk është feja e parë e cila ndaloi ngrënien e mishit të derrit. Feja hebraike këtë e ka ndaluar dhe kështu deri më sot nuk ka hebraik në Evropë dhe Amerikë që e konsumojnë mishin e derrit - pos në raste të rralla, dhe askush nuk i kritikon për këtë. Përkundrazi, respektohen traditat fetare të hebrenjve.

Me ardhjen e Isait a.s. ashtu siç hasim në Inxhil, ai deklaroi se nuk ka ardhur që të kundërshtojë ligjin, por për ta plotësuar atë. Pra, nuk ka ardhur për të ndryshuar dispozitat ligjore hebraike, e mes tyre natyrisht edhe ndalimin e mishit të derrit. Duke u mbështetur në këtë, arsyeja thotë se mishi i derrit duhet të jetë i ndaluar edhe në fenë krishtere.⁶⁴

2. Me ardhjen e Islamit, gjithashtu u ndalua ngrënia e mishit të derrit, por kjo ndalesë është



⁶⁴ El Kardavi, Jusuf: "El Halalu vel Haram", Doha Katar 1978, f.42.

vazhdimësi e ndalesës së feve të mëparshme qiellore. Kur'ani Fisnik këtë ndalesë e përmend qartazi në katër vende.⁶⁵ Në anën tjetër, përkrah kësaj ndalese fetare, ekzistojnë edhe shumë shkaqe të tjera të cilat e mbështesin këtë ndalesë. Ndër to edhe ajo çfarë u argumentua nga dijetarët myslimanë se ngrënia e mishit të derrit është shumë i dëmshëm për shëndetin, sidomos në vendet e nxehta. Përveç kësaj, ajetet kur'anore në të cilat përmendet ndalesa e ngrënies së mishit të derrit, përfshijnë edhe ndalimin e ngrënies së të ngordhurës dhe gjakut. Dëmi nga ngrënia e të ngor-



⁶⁵ “(Allahu) Ua ndaloi juve vetëm të ngordhtën, gjakun mishin e derrit dhe atë që theret jo në emër të Allahut. E kush shtrëngohet (të hajë nga këto) duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtetë Allahu falë, është mëshirues.” (el Bekare 173)

“Juve u janë ndaluar ngordhësitra, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emër të Allahut, e furnja, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetres), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta themi (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj..” (el Maide 3)

“Thuaj: Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai është coftinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë, dhe pos asaj që është therur jo në emër të Allahut e që është mëkat. E kush shtrëngohet (t'i hajë këto të ndaluara), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, Zoti yt është që falë e mëshiron shumë” (el En'amë 145)

“Ai ua ndaloi juve vetëm cofëtinën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret jo në emër të Allahut. E kush shtrëngohet (t'i hajë) duke mos qenë dhunues dhe duke mos e tepruar, Allahu falë dhe është mëshirues.” (en Nahë: 115)

dhurës dhe gjakut është i pamohueshëm pasi në të mblidhen mikrobe dhe lëndë të dëmshme, kjo argumenton se edhe ngrënia e mishit të derrit është i dëmshëm.

Nëse metodat moderne kanë arritur eliminimin e materieve të dëmshme të mishi i derrit, gjaku dhe organet e brendshme, kush mund të na sigurojë se në të nuk ekzistojnë edhe të tjera materie të dëmshme që akoma nuk janë zbuluar. Njeriu pati nevojë për shekuj të tërë për të zbuluar një rrezik të vetëm. Allahu i cili krijoi njeriun, është më i dijsmi mbi të, din se çfarë i sjell rrezik e çfarë është në të mirën e tij. Këtë të vërtetë Kur'ani Famëlartë e vërteton me këtë ajet fisnik:

“.. e mbi çdo të ditur ka edhe më të ditur.”
(Jusuf: 76)

3. Në bazë të normës së njohur: *“Nevaja lejon atë që në esencë ndalohet.”* Islami për raste kur nga uria rrezikohet jeta, lejoi ngrënien e mishit të derrit. D.m.th. myslimani kur gjendet në situatë që për ta shpëtuar jetën duhet të ushqehet me ushqim të ndaluar, e ndër to edhe mishi i derrit, i lejohet dhe atij nuk i shënohet mëkat. Në këtë na mëson ajeti kur'anor:

“.. e kush detyrohet (të hajë nga këto) duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tep-

ruar, për të nuk është mëkat. Vërtetë Allahu falë, është mëshirues.” (el Bekare:173)

Mirëpo ky lejim nuk lejon tejkalim të kufijve të domosdoshmërisë, nëse diçka e këtillë ndodhë, myslimani është mëkatar.

(IV) PSE ISLAMI NDALOI VESHJEN E MËNDAFSHIT DHE ARIN PËR BURRAT?

1. Kjo ndalesë është bërë në bazë të thënieve të shumta të Pejgamberit dhe është miratuar nga shumica e dijetarëve myslimanë. Mendimi i tyre është se forca dhe vendosmëria është karakteristike e burrit, dhe Islami e mbron mendimin se burri nuk duhet që të jetë i rrethuar prej asnjë far lloji dobësie, ose me shenja luksoze, sepse luksi shpesh shkon dorë për dorë me padrejtësitë sociale. Kjo që burri të jetë i vendosur, i fortë dhe triumfal në betejat e jetës si dhe në mejdanet e luftës, nëse e kërkon nevoja. Pasi që stolisja me arin dhe veshja e mëndafshit konsiderohen si nga gjërat luksoze, ato Islami i ka ndaluar për burrat, kurse i ka lejuar për gratë. Lejimi për gratë është në përputhshmëri me natyrën e tyre dhe dëshirën që kanë ndaj stolive.⁶⁶



⁶⁶ El Kardavi, Jusuf: “**El Halalu vel Haram**”, f.80.

2. Përkundër ndalesës, nëse eventualisht paraqitet nevoja që për shkaqe shëndetësore burri duhet të vishet me rrobe mëndafshi, Islami një gjë të tillë e lejon dhe nuk e pengon. Kështu Muhamedi a.s. i ka lejuar Abdur Rahman Ibën Avfit dhe Zubejr Ibën Avamit që të veshin rrobe prej mëndafshi për shkak të sëmundjes që e kishin.⁶⁷

3. Imam Shevkani, (ndërroi jetë më 1840) në librin e tij të njohur "*Nejl el Evtar*" në lidhje me këtë çështje thotë se hadithet e Pejgamberit a.s. mbi veshjen e mëndafshit argumentojnë se bëhet fjalë vetëm për *mekruh* – e papëlqyer, dhe jo për ndalim. Pra diçka që për një shkallë është më e lehtë se *harami* - ndalimi. Imam Shevkani këtë mendim të tijin e thotë ngase ka pasur jo më pak se njëzet sahabë të Pejgamberit a.s. që e kanë mbajtur e ndër to Enesi, El Bera Ibën Azib. Kështu që nuk do të ishte e logjikshme që këto sahabë të mbanin atë që është e ndaluar. Sikurse gjithashtu është e pranueshme që sahabët e tjerë të heshtnin duke e ditur se bëhet fjalë për haram.⁶⁸

4. Kurse sa i përket unazës së arit për burrat, shumica e dijetarëve duke u mbështetur në disa hadithe të pejgamberit e ndalojnë. Mirëpo ka një



⁶⁷ Shovkani: "*Nejlul Evtar*", Vëll.II, *Dar el Xhejl*, Bejrut, 1973, f.81.

⁶⁸ Po aty, f.73 dhe Sabik, Sejid: "*Fikhus sune*", Vëll.III, f.481.



SHËNIM MBI AUTORIN

Prof. Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk është i lindur më 27 dhjetor 1933 në Dekhelije- Egjipt. Fakultetin e gjuhës arabe pran Universitetit të Ezherit e kreu më 1959 kurse doktoroi në filozofi më 1968 në Universitetin e Mynhenit. Një vit më vonë emërohet si ligjërues i Filozofisë islame në Fakultetin e Usuli Dinit pran Universitetit të Ezherit, në të cilin punoi deri në vitin 1996 dhe për disa vite ishte edhe dekan (1987-1989 dhe nga viti 1991-1995). Nga viti 1995 e deri në vitin 1996 para se të emërohet Ministër i Vakufit, ishte edhe prorektor i Universitetit të Ezherit.

Prof. Zakzuk është pjesëmarrës në shumë konferenca ndërkombëtare lidhur me relacionet

ndërkulturore, ndërcivilizuese, ndërfetare në të cilat është aktiv që nga viti 1980.

Profesori i nderuar është anëtarë, respektivisht drejtues i disa institucioneve, organeve, ligave, kuvendeve dhe komisioneve në të cilat kontribuon vazhdimisht. Është për t'u nënvizuar se Prof. Zakzuk përkundër funksionit që ka mbi një decaenie, ai për asnjë moment nuk hoqi dorë nga hulumtime në fusha të ndryshme, çëshjte kjo që padyshim flet se kemi të bëjmë me një figurë të rallë të umetit mysliman.

Prof. Zakzuk është anëtar i Institutit për hulumtime islame të Ez-herit, kryetar i Këshillit Suprem për Çështje Islame, anëtar i Këshillit Suprem të Ez-herit, anëtar i Lidhjes së shkrimëtarëve, kryetar i Kuvendit të Shoqatës për Filozofi si dhe drejtues i Komisionit të përhershëm shkencor për avancim të profesorëve në lëminë e Akaidit dhe Filozofisë pran Universitetit të Ez-herit.

Profesori i nderuar është autor i disa veprave mbi Islamin, filozofinë e përgjithshme, filozofinë islame, filozofinë moderne, etikën, civilizimin, të shkruara në gjuhën arabe dhe atë gjermane, disa prej të cilave janë përkthyer edhe në anglisht, frengjisht, rusisht etj.

Po përmendim disa prej tyre:

"el menhexh el felsefi bejne El Gazali ve Dekart",

"el islam fi tesavurat el garb",

“mukadimefi ilm el ahlak”,
“dirasat fi el felsefe el hadithe”,
“temhid lilfelsefe”,
“mukadimefi el felsefe el islamije”,
“el islam fi mira’t el fikër el garbi”,
“ed din vel hadare”,

“ed din vel felsefe ve et tenvir” etj.; vepra këto të cilat sikur të shqipëroheshin do të zgjonin interes në shtresën intelektale.

Në vitin 1997, për veprimtarinë e tij të bujshme profesori i nderuar shpërblehet me çmimin shtetëror në shkencat shoqërore nga Këshilli Suprem për Kulturë. Neve nuk na ngelet tjetër postë shpresojmë dhe punojmë në shqipërimin e veprave të tij dhe ta lusim Allahun Fuqiplotë që autorin ta ndihmojë në punë dhe ta shpërblejë me xhenet.

الصورة الذاتية للمؤلف

الأستاذ الدكتور محمود حمدي زقزوق مواليد شربين الكوم
محافظة الدقهلية في 1933/12/27م جمهورية مصر .

المؤهلات العلمية

- حصل علي الإجازة العالمية من كلية اللغة العربية
من جامعة الأزهر عام 1959م
- حصل علي شهادة الدكتوراة في الفلسفة من جامعة
ميونيخ
بألمانيا عام 1968م

التدرج الوظيفي

- عين مدرسا للفلسفة الإسلامية مادة أصول الدين في
جامعة الأزهر عام 1969 - أستاذ مساعد عام 1974 -
1979م
- عمل وكيلا لكلية أصول الدين بجامعة القاهرة ورئيس
قسم الفلسفة والعقيدة (1978 - 1980م)
- عميد لكلية أصول الدين بجامعة الأزهر في الفترة ()
1987 - 1989) ومن عام (1991 - 1995)
- نائب رئيس جامعة الأزهر عم 1995م
- وزيرا للأوقاف علم 1996م

المؤتمرات التي شارك فيها

- المؤتمر الدولي للعلاقات الثقافية في مدينة بون بألمانيا
عام 1980م

- المؤتمر السنوي للجمعية الدولية لتاريخ الأديان بجامعة هامبورج بألمانيا - عام 1988م
- مؤتمر دار حضارات العالم في برلين بألمانيا عن الإتجاهات الإسلامية المعاصرة - عام 1991م
- مؤتمر مركز أبحاث الحوار (حريصا) لبنان - عام 1995م

الهيئات التي ينتمي إليها

- عضو مجمع البحوث الإسلامية بالأزهر
- رئيس المجلس الأعلى للشؤون الإسلامية
- عضو المجلس الأعلى للأزهر
- عضو اتحاد الكتاب
- رئيس مجلس إدارة الجمعية الفلسفية المصرية
- مقرر اللجنة العلمية الدائمة لارقية الأساتذة في العقيدة والفلسفة بجامعة الأزهر
- ولقد مر فترة زمنية بعمله ونشاطه الدائم ولم يترك فراغ من عمله الدؤوب المتواصل في مختلف الحقول العلمية لحياة المواطن المسلم وتعتبر شخصيته نادرة النوع في الأمة الإسلامية المعاصرة، بعبقريته .

- المؤلفات

- الأستاذ الموقر مؤلف للعديد من الكتب والمؤلفات الإسلامية ، فلسفة عامة ، الفلسفة الإسلامية ، الفلسفة الحديثة ، الأخلاق ، المدنية ، مؤلفة باللغة العربية واللغة الألمانية ، وعدد من هذه الكتب تمت ترجمتها ونشرها باللغات الأنكليزية ، الفرنسية والروسية وغيرها من اللغات، نذكر من الكتب:
- المنهج الفلسفي بين الغزالي وديكارت - الكويت عام 1983م

PËRMBAJTJA

Përkushtim	10
PARATHËNIE	11
Hyrje	15
KREU I PARË.....	19
Kur'ani Fisnik.....	21
(I) Kur'ani, shpallje hyjnore apo e arritur njerëzore?.....	21
(II) A thua Kur'ani është krijuar në bazë të feve të mëparshme.....	25
(III) A është e vërtetë se Kur'ani Fisnik nuk solli risi?.....	28
(IV) A thua tubimi i Kur'anit ka shkaktuar ndonjë dyshim në autenticitetin e tekstit të tij?.....	30
KREU I DYTË.....	35
Pejgamberi Muhamed a.s.....	37
(I) A thua Muhamedi a.s. me porosinë për Islamin u dërgua vetëm për arabët ose për mbarë njerëzimin?.....	37
(II) Cilat kanë qenë shkaqet e martesave të Pejgamberit a.s.?.....	39
(III) Sa është bindja në autenticitetin e Sunetit - traditës së Muhamedit a.s.?.....	42
(IV) A ekzistojnë kundërthënie në hadithet e Pejgamberit a.s. ?.....	46

KREU I TRETË.....49

Përhapja e Islamit, e vërteta mbi xhihadin dhe çështja e dhunës.....	51
(I) A ishte i zgjeruar Islami përmes shpatës?.....	51
(II) A ishin qirimet islame formë e kolonializmit?	54
(III) Cili ishte qëndrimi i myslimanëve mbi civili- zimet e lashta dhe djegies së bibliotekës së Aleksa- ndrisë?	57
(IV) Cila është e vërteta e Xhihazit në Islam?.....	60
(V) A thërret Islami në ekstremizëm dhe dhunë?	64
(VI) Cili është qëndrimi i Islamit ndaj fanatizmit dhe terrorizmit?.....	68

KREU I KATËRT73

Islami dhe çështjet e njeriut.....	75
(I) Cila është e vërteta e lidhshmërisë mes Allahut dhe njeriut?.....	75
(II) Cili është qëndrimi i Islamit mbi mendjen (arsyen) e njeriut?	78
(III) A është e vërtetë se Islami thërret në fatalizëm?.....	81
(IV) Cili është qëndrimi i Islamit në lidhje me demokracinë dhe të drejtat e njeriut?.....	84
(V) Cili është qëndrimi i Islamit lidhur me artin?	89

KREU I PESTË.....93

Islami mbi pozitën e gruas.....95

(I) A është e vërtetë se Islami diskriminon gruan dhe privon të drejtat e saja?95

(II) A është gjithnjë gruaja e nënshtruar burrit?..98

(III) Përse në trashëgimi gruas i takon më pak se burrit?..... 100

(IV) Përse gratë *diskreditohen* në çështjen e dëshmisë?..... 104

(V) Cili është qëndrimi Islam mbi pozita të larta udhëheqëse të gruas? 107

(VI) Cili është qëndrimi i Islamit mbi hixhabin e gruas dhe të drejtat e saja për shkollim dhe punë? 109

(VII) A është mbulesa e papërshtatshme për jetën moderne?..... 111

(VIII) Pse Islami lejon poligaminë?..... 114

(IX) A paraqet ndalimi i martesës së myslimanës mejomysliman tendencë raciste?..... 116

KREU I GJASHTË..... 119

Liritë në fe, bashkimi islam dhe prapambeturia e disa prej kombeve islame..... 121

(I) A është e vërtetë se Islami kundërshton lirinë e besimit?..... 121

(II) A është qëndrimi i myslimanëve ndaj Selman Ruzhdiut kundër lirisë së të shprehurit?..... 124

(III) A është e vërtetë se sanksionet në Islam janë brutale dhe të egra?	127
(IV) Ku qëndrojnë shkaqet e përçarjes së myslimanëve përkundër thirrjes Islame për unitet?.....	131
(V) A është Islami fajtor për prapambeturinë e myslimanëve?.....	134

KREU I SHTATË..... 139

Pyetje lidhur me dispozita të caktuara islame.....	141
(I) A e pengon agjërimi produktivitetin?.....	141
(II) A është e vërtetë që zeqati të pasurve u jep përparësi ndaj të varfërve në arritjen e mirësisë së Allahut xh.sh.?.....	143
(III) Pse Islami e ka ndaluar ngrënien e mishit të derrit?.....	146
(IV) Pse Islami ndaloi veshjen e mëndafshit dhe arin për burrat?.....	149
Shënim mbi autorin	153
Shënim mbi autorin në gjuhën arabe	153

CIP - Katalogizacija v publikaciji
Nacionalna i univerzitetna biblioteka "sv. Kliment
Ohridski" – Skopje

297

ZAKZUK, Mahmud Hamdi

Të vërtetat islame / Mahmud Hamdi Zakzuk: Përktheu nga
anglishtja Afrim Tahiri – Shkup : Bashkësia fetare Islame e R.
Maqedonisë, 2010. 165 str : 21 cm

Nasl ov na or i g nal ot na ar ap. Jazi k

ISBN: 978-9989-792-12-0

a) I sl am

COOBISS.MK-ID 81470218



9 789989 792120